ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E ENJTE, 28 JANAR 2021. NUMËR 115. VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

SOT DITËLINDJA E KADARESË

Kur në letra të ndryshme (anketa, kërkesë për vizë etj.) shënoj datën e lindjes, 28 janar 1936, vetëtimthi më shkon nëpër mend fjala "e mërkurë". Ti ke lindur të mërkurën, më thoshte shpesh im atë, thua se kjo kishte një rëndësi më vete. Kur ishte në qejf, çka ndodhte rrallë, shtonte se atë të mërkurë, usta Vasili, që e kishim fqinj dhe që na riparonte pullazin e pjesës perëndimore të shtëpisë, porsa e kishte lënë punën për të ngrënë drekë, dhe, ndërsa zbriste nga shkalla, e kishte uruar babanë: me një djalë!

EDHE NJËQIND, MJESHTËR!

BESIMI TE LETËRSIA E KADARESË I NGJASHËM ME BESIMIN TE HYJNIA
nga Bujar Hudhri (fq. 23)

Admirimin për Kadarenë e kam mbajtur brenda vetes
nga Sadik Bejko (fq. 13)

Refuzimi për ta riprodhuar strukturën autoritare në letërsi
nga Ali Aliu (fq. 14)

Dyndje kujtimesh
nga María Roces González (fq. 15)

Për shume vjet, Maestro!
Nga Marius Dobrescu (fq. 21)

Kadare ka ruajtur dinjitetin e letërsisë shqiptare gjatë komunizmit
nga Joachim Röhm (fq. 13)

Diptik me Kadarenë
Nga Visar Zhiti (fq. 10)

Udhëtimet nëpër Gjirokastër
Nga Dorota Horodyska (fq. 19)

Kadare në Londër
Nga John Hodgson (fq. 17)

Takimi i parë me Is.
Nga HELENA KADARE (fq. 4)

Disa ditë radhazi, pas këtij takimi fatlum, isha si e dehur nga tronditja. E sillja dhe e risillja në mend takimin në rrugë, fytyrën e tij, sytë shpotitës prapa syzeve me skelet të trashë, dorën e tij të zbehtë dhe disi nervoze, me të cilën kishte shkruar me shpejtësi e shtrembtas atë numër telefoni. Tërë ditën mendja më rrinte te telefoni. Po sikur ta merrja? Po sikur ai të më ftonte t'i vija? Po sikur, po sikur. Telefona në Tiranë në atë kohë kishte fare pak ...

Kur përktheja Kadarenë
Nga Mira Meksi (fq. 18)

Një vështrim tipologjik mbi *Ismailandin*
Nga Matteo Mandalà (fq. 16)

JOHN UPDIKE
Kronikë në gur, një roman magjepsës
"The New Yorker", 14 mars 1988 (fq. 20)

BIBLIOTEKË
Kalimet e nëndheshme (fq. 11)
Për të harruar një grua (fq. 12)
Kristal (fq. 14)
Në parkun që e mbuluan fletët

Një intervistë me Kadarenë para gjysmë shekulli
Nga Mehmet Kraja (fq. 8)

Në qenien letrare
Nga Bashkim Kuçuku (fq. 22)

Sot në libraritë kryesore të Tiranës

"KOHË PËR RRËFIM"
KADARE
dialog me Alda Bardhylin
Fragment nga libri (fq. 10)

Shkrimtari ka dy jetë krijuese, një të gjatë e monotone e një tjetër të shkurtër si shkreptima

Nga ISMAIL KADARE

Ismaili, bebe, me të motrën, Kadrien

Kur në letra të ndryshme (anketa, kërkesë për vizë etj.) shënoj datën e lindjes, 28 janar 1936, vetëtimthi më shkon nëpër mend fjala "e mërkurë". Ti ke lindur të mërkurën, më thoshte shpesh im atë, thua se kjo kishte një rëndësi më vete. Kur ishte në qejf, çka ndodhte rrallë, shtonte se atë të mërkurë, usta Vasili, që e kishim fqinj dhe që na riparonte pullazin e pjesës perëndimore të shtëpisë, porsa e kishte lënë punën për të ngrënë drekë, dhe, ndërsa zbriste nga shkalla, e kishte uruar babanë: me një djalë!

Disa minuta më pas, në dhomën e dimrit, që ndodhej pikërisht në atë pjesë të shtëpisë, pullazi i së cilës riparohej, linda unë. Ndonëse nuk e shpjegonte, kuptohej që babai i jepte një kuptim të jashtëzakonshëm urimit të mjeshtrit, që ishte duke vendosur pllakat e gurta, krejt si një mburojë sipër meje, në kohën që unë vija në jetë.

Im atë ishte i gjatë, i drejtë, fliste pak dhe, përgjithësisht, rrinte i zymtë. Vjen i ftohtë, i thoshin gjyshes shoqet për të, dhe me bisht të syrit vështronin nga unë, thua se donin të kuptonin a do t'i ngjaja. Kishte punuar disa vjet në Afrikën Veriore dhe ishte ndoshta kjo arsyeja që më kishte thënë disa herë se viset më të bukura në botë duhej të ishin vendet skandinave. Nuk kishte qenë kurrë atje, por i lodhur, siç duket, nga zhegu i shkretëtirës, nuk ëndërronte veç vise të ftohta. Kishte qenë, ndoshta, kjo arsyeja që pas kthimit nga Afrika kishte pranuar të punonte vite me radhë si ftues gjyqi në Alpet e Shqipërisë Veriore.

Gjyshin nuk e mbante mend askush në Gjirokastër. Kishte vdekur fare i ri, njëzet e pesë ose njëzet e tetë vjeç, fill pas martesës dhe pas mbarimit të studimeve të larta në Stamboll. Atje dhe u varros, pa u kthyer dot në qytetin e lindjes. Në shtëpinë tonë flitej përherë për një kësoll të madh në Stamboll, kësollin e gjyshit, dhe qysh herët në ndërgjegjen time fjala "Stamboll" shoqërohej gjithmonë nga një ceremoni funebre.

Ndryshe nga gjyshi, që i ngjasonte një fantazme, stërgjyshi kishte qenë për mua më i prekshëm. Kur në moshën dymbëdhjetëvjeçare botova vjershat e para, nisa të dëgjoj përherë e më shpesh komentet e shoqeve të gjyshes: do të bëhet i dëgjuar si Ismail Kadareja. Kështu quhej stërgjyshi im, i cili paskësh qenë i dëgjuar në Gjirokastër për... kalcunjat (lloj çorapesh) e bukura që mbante. Me fjalë të tjera, për ndjekjen e modës. Paskëshin qenë kaq të bukura kalcunjat e tij, saqë në një këngë të njohur gjirokastrite, ku këngëtari rendiste gjërat që mund ta bënin të lumtur një njeri, krahas "sarajeve të vezirit", "kopshtit të Çelo Kailit", "nuseve të Dane Bakirit" dhe "zërit të bilbilit", ishin dhe "kalcunjat e Ismailit".

Kështu që më pëlqente ose jo, ideja e famës iu shfaq së pari ndërgjegjes sime në formë çorapesh të bukura. Në vitet studenteske, sidomos në ato të Moskës, kur pasioni për letërsinë m'u zbeh ca kohë, për shkak të ndjekjes së modës, disa herë më janë kujtuar, bashkë me fjalët: "ka për t'u bërë i dëgjuar si Ismail Kadareja", kalcunjat e stërgjyshit. Me sa dukej, fama u mëdysh në fisin tonë midis sqimës në të veshur dhe letrave, dhe turbullira ime moskovite s'qe veç një shenjë e fundit që më dërgonte im stërgjysh

Ismaili, fëmijë, në oborr të shtëpisë

për të më mbushur mendjen se lavdia më e sigurt ishte ajo e tij.

Në "Kronikë në gur" e kam përshkruar hollësisht shtëpinë e lindjes ose, më saktë, pjesën e saj veriore ku ne banonim. Hynte në ato lloj shtëpish të Gjirokastrës që, ashtu si njeriu, që një pjesë të trupit e ka të gjymtë, edhe ato, një pjesë e kishin të rrëzuar. Kjo ishte ana jugore e saj. Kështu e mbaja mend gjithmonë: ca mure mbi një urë që shërbente si kalim për në lagjen e të krishterëve, pastaj vinte një pjesë e braktisur, ngaqë s'qe e sigurt për të jetuar, pastaj pjesa ku banonte një tjetër Kadare dhe, së fundi, ana jonë.

Kur isha i vogël më dukej e natyrshme që shtëpitë të nisnin kështu: nga ca mbeturina muresh, me ca shkurre mbi to, me fjalë të tjera, nga hiçi. Pastaj dalëngadalë muret ngrinin kokën, gjithçka mblidhej e tendosej gjer te pjesa e braktisur, por që ende ishte e frikshme. Më tutje niste shtëpia e vërtetë, që sa vinte forcohej e përkryhej, gjersa mbërrinte në skajin tonë verior. Isha i bindur se ajo qe pjesa më e përsosur e krejt ngrehinës, jo vetëm se ishte më larg rrezikut, dhe jo aq për dhomat plot dritë të katit të tretë, sesa për pjesën nëntokësore të saj. Ajo ishte, në të vërtetë, krenaria ime, tmerri dhe gëzimi im.

Përbëhej nga dy kubé që lidheshin me njëra-tjetrën, e madhja dhe e vogla, por që në ndërgjegjen time shtresoheshin si "zonja e madhe" dhe "zonja e vogël". Por kurora e pjesës nëntokësore ishte sterna e madhe e ujit: Hadesi i shtëpisë sonë.

Kur kam thënë andej-këndej se dy kubetë dhe sidomos sterna e ujit, më shumë ndoshta se biblioteka e qytetit, më kanë pjellë mua si shkrimtar, kjo, edhe duke mos qenë krejt e saktë, ka një të vërtetë të madhe.

Që nga humbella ku ishte, sterna e trazonte përfytyrimin tim më fort se gjërat e dukshme. Kjo vinte ndoshta ngaqë ajo, ndonëse e zhytur në nëntokë, jepte e merrte me qiellin më shumë se gjithçka tjetër. Ajo mbushej nga shiu, pra nga qielli, kështu që qysh herët ajo i dha trurit tim një përmasë trizonëshe të botës: qiellin, nëntokën dhe ndërprerjen e herëpashershme midis tyre. Kjo ndërprerje ndodhte te qyngji bashkues, të cilin, në raste shirash të mëdha, babai e shkëputste, për të shmangur mbimbushjen e sternës.

Soditja e ujit mbi çatinë e çmendur e të pjerrët përpara se të mbyllej në atë burg, dëgjimi i zhurmës së tij, vetëtimat që e braktisnin, në prag të fatkeqësisë, shfytyrimi i tij atje thellë, gjëmimi i mbytur, përpjekja për të shpërthyer sternën, së fundi, dalja si prej burgut, por i skllavëruar tashmë, i vënë në kova për të larë në mënyrë të turpshme dyshemetë dhe enët, të gjitha këto jepnin në mendjen time në një pikëshikim, si të thuash ujor (çka pritej prej një të linduri nën shenjën e Akuariumit), një pjesë të dramës së njerëzimit.

Nganjëherë, kur me anë të një pasqyre të vogël i dërgoja pakëz dritë, për të zbuluar diçka nga misteri i saj, s'bëja gjë tjetër veç:

I jepja qiell, merrja prej saj skëterrë.

Por ndoshta më shumë se ajo për qiellin tim, isha unë që kisha nevojë për ferrin e saj.

Ndonëse kur isha i vogël rrënimi në pjesën jugore të shtëpisë më dukej aq larg, me kalimin e viteve, ai iu afrua pjesës sonë.

Tani shtëpia është ende në këmbë, por e dëmtuar. Duke qenë qytet-muze, me dhjetëra janë ngrehinat që riparohen çdo vit. Ato janë banesa karakteristike ose shtëpi ku kanë banuar njerëz të shquar të qytetit: dijetarë, dëshmorë ose funksionarë të rëndësishëm në shërbim të shtetit. Për të penguar rrënimin, në kërkim të një përligjjeje, kam menduar të përdor emrin e emnakut tim të largët, stërgjyshit. E kam ende në shtëpi një kërkesë për Komitetin Ekzekutiv të Qytetit, ku shkruaj se "meqenëse stërgjyshi im, Ismail Kadare, është i përmendur në baladat popullore si një njeri që vishej me shije sipas traditës, duke dëshmuar kështu kulturën e lashtë të kombit tonë, autoktoninë e shqiptarëve si pasardhës të ilirëve etj., etj., ndoshta shihet e arsyeshme prej jush që shtëpia e Kadarenjve, një nga më të vjetrat e qytetit, të hyjë në numrin e ngrehinave që mirëmbahen nga shteti".

Nuk e dërgova kërkesën, jo se doja të shmangia një konkurrim të ri midis meje dhe sqimatarit, stërgjyshit tim, konkurrim për të cilin isha i sigurt se ai do ta fitonte, por ngaqë më dukej se kujtimi i tij do të fyhej, kur të çmohej prej burokratësh që s'dinin, veç të tjerash, as të visheshin.

Me idenë e vdekjes njeriu njihej herët në Gjirokastër, për shkak të zive të gjata që mbaheshin. Pothuajse çdo shtëpi kishte orën e vajit, kur kujtoheshin të ikurit.

Ngjyra e zezë dhe lulet e kanë shoqëruar këtë ide në mendjen time qysh në kohën që kuptova se njerëzit në këtë botë ishin të përkohshëm. Por lulet, ndonëse qenë të rralla në këtë qytet, qenë zotëruese kur flitej për vdekjen. Kjo vinte, me sa dukej, ngaqë varreza e qytetit thirrej "Vasilikua", për shkak të borzilokut. Eh, siç duket, jam nisur për Vasilikua, thoshin plakat midis dy psherëtimave. Kur të vete në Vasilikua. Mos u mërzit, se do vete në Vasilikua. Do të shihemi në Vasilikua. Ishin fraza aq të zakonshme në jetën e përditshme, saqë, në fëmininë e hershme unë kujtoja se një pjesë e njerëzve shkonin vetë atje, me këmbët e tyre dhe pastaj se si ndodhte që mbeteshin midis luleve e s'ktheheshin më. Më pas kuptova se, ndonëse ashtu thoshin, askush nuk shkonte me këmbët e veta, por i çonin të tjerët.

Nganjëherë, në arkivol u vinin edhe dylbitë, dhe mua më dukej se që nga varret ata vështronin tani me dylbi qytetin, ashtu si të gjallët vështronin varrezën. Nganjëherë, kur në hapësirë kishte farfurima drite, më dukej se ato përthyerje s'ishin veç kryqëzimet e vështrimeve të të dyja palëve.

Kur isha katërmbëdhjetë-pesëmbëdhjetë vjeç, më dukej mosha mbi njëzet vjeç tepër e mërzitshme. Vetë fjala "njëzet" më ngjante se ishte ngjizur me mërzi dhe fillim pleqërie.

Kur isha njëzet e dy-njëzet e katër vjeç, ndonëse shqyhesha gazit me marrëzinë e parë, isha i bindur se, sidoqoftë, koha më e mirë për një shkrimtar për të vdekur ishte aty nga tridhjetë e një-tridhjetë e dy vjeç. Kur e mbërrita këtë kohë, ideja ime për moshën pësoi një trandje njëherë e përgjithmonë.

Ishte pak a shumë në atë kohë që e ndjeva së pari se shkrimtari ka dy jetë krijuese, një të gjatë e monotone e një tjetër të shkurtër si shkreptima. Që shkrimtari është, gjithashtu, dymoshës (mosha fizike e tij dhe mosha e famës ose, së paku, e kujtimit të tij, qoftë edhe me një famë gjysmë të shuar), këtë e dija qyshkur. Ajo që zbulova ishte tjetër gjë dhe pikërisht që kjo dymoshësi ose, më saktë, mosha e tij e dytë, ajo e madhja, është dhe një nga shkaqet e keqkuptimeve midis shkrimtarit dhe kohës së vet.

Keqkuptimet janë të pashmangshme, po të kujtojmë se kur një njëzetvjeçar e ka vështirë të merret vesh me një tetëdhjetëvjeçar, si do ta ketë të lehtë të kuptohet me një tetëqindvjeçar (që është mosha mesatare për shkrimtarin e shquar) e aq më shumë me një dymijëvjeçar (moshë mesatare e të mëdhenjve)?

E keqja është se qysh se është gjallë (domethënë në moshën e tij të parë), shkrimtari e ndien moshën e dytë. Ai ndien peshën e saj, lumturinë, trishtimet dhe gjithçka tjetër të saj, që, duke qenë të përmasave të tjera, ngjajnë të mbikësojetshme.

Ai është dyzet vjeç, por një zë i brendshëm i thotë: në të vërtetë, ti je ende dy vjeç, kështu që sipas kalendarit tjetër, atij të dytit, ti ke ende një mijë e katërqind vjet për të jetuar. Por në moshën e dytë të shkrimtarit kalendari mund të ecë mbrapsht, domethënë shkrimtari, me kalimin e viteve, në vend të plaket, mund të rinohet edhe më.

Të gjitha këto sjellin në jetën e shkrimtarit një tjetër ajër e tjetër klimë nga të tjera zona. Që e gjithë kjo të shëmbëllehet me punët hyjnore, çka edhe shpesh është bërë, gjithashtu është e kuptueshme. Më shumë se një vetëmburrje e shkrimtarëve, ky hyjnizim i punës së tij ka ardhur nga vështirësia për të shpjeguar të fshehtën e dy kalendarëve.

Kadare në familje. Me Helenën dhe dy vajzat, Gresën dhe Besianën, Tiranë, 1974

HELENA KADARE

Takim i parë me Is.

Po ecja vetëm në Rrugën e Barrikadave dhe në udhëkryq, atje ku ajo pritej me rrugën "Qemal Stafa", befas njoha fytyrën që e kisha parë veç nëpër fotografi. Po vinte përballë meje, mbi trotuar, bashkë me tim kushëri, shkrimtarin Nasho Jorgaqi. Ecnin duke qeshur të dy. Mua m'u duk më simpatik se në fotografi. Kishte një xhaketë me kokrriza dhe mbante një pulovër të zi me jakë golf, që sapo kishin dalë në modë në atë kohë. M'u duk po aq i zbehtë në fytyrë, sa ç'e kisha përfytyruar në ëndërrimet e mia. U turbullova aq shumë, sa m'u duk se po më merreshin këmbët.

Nasho Jorgaqi ndaloi për të më takuar, pastaj më njohu me të.

- Kjo është kushërira ime, Elena Gushi, - tha.

U skuqa, veshët më buçisnin dhe belbëzova, ca fjalë gati si përçart.

"Ju njoh. E di që jeni një poet mendjemadh. Nuk i jeni përgjigjur letrës sime."

Këto ishin pak a shumë fjalët, siç m'i kujtoi Is më pas, sepse unë s'mbaja mend gjë prej gjëje. Ai seç u përgjigj gjysmë me të qeshur, ndërsa im kushëri shfaqi habinë që paskemi këmbyer letra.

Is pyeti:

- Ju jeni tani në Tiranë?

Pas pohimit tim, pa m'i hequr sytë, ai vazhdoi:

- Ju pëlqen të shikoni filma të xhiruar prej meje?

Mezi e mora vesh ku e kishte fjalën. Ishte shqiptari i parë që kishte sjellë nga jashtë një kinoaparat 8 mm, bashkë me laboratorin për larjen e filmave.

- Më pëlqen shumë, - u përgjigja, e çliruar ngaqë biseda mori një drejtim gazmor.

Kushëriri im u vrenjt nga kjo mënyrë e pacipë ftese në shtëpi. Unë u skuqa prapë dhe s'dija ç'të përgjigjesha. Pa çarë kryet për fytyrën e ngrysur e qortuese të kushëririt, Is nxori një copë letër nga xhepi dhe shkroi në të.

- Ky është telefoni im. Më merrni ndonjë ditë.

Krejt e turbulluar e mora letrën dhe Is shtoi:

- Po e humbët këtë pusullë mbani mend këtë: dy numrat e parë janë viti i vdekjes së Stalinit dhe... (tani nuk më kujtohet ç'ishte ngjarja tjetër, ngaqë e vendosur ta ruaja si floririn atë letër, s'i dhashë rëndësi përcaktimit).

Im kushëri ishte ngrysur edhe më fort. Kur më takoi më pas, ai më hoqi vërejtjen me shumë seriozitet. Kishte dashur ta bënte këtë gjë edhe me Is, por, ngaqë atij ishte vështirë t'i bëje vërejtje të kësaj natyre, i kishte kujtuar se unë isha e fejuar dhe s'ishte mirë që në sytë e tij, domethënë të kushëririt, ai më kishte bërë haptas një propozim për takim.

Më pas mora vesh hollësira të bisedës së tyre. E fejuar? E çfarë pastaj? kishte thënë Is, gjë që e kishte pezmatuar edhe më fort kushëririn tim.

Asnjëherë nuk e mora vesh nëse ishte vërtet fare mospërfillës për të fejuarin apo ashtu shtirej. E vërteta është se as atëherë, as më pas nuk më ka pyetur kurrë për të, sikur ai të mos kishte ekzistuar ndonjëherë. Kjo shmangie e të fejuarit ndikoi, me sa duket, që edhe tek unë të ndodhte e njëjta gjë, me të njëjtën lehtësi.

Disa ditë radhazi, pas këtij takimi fatlum, isha si e dehur nga tronditja. E sillja dhe e risillja në mend takimin në rrugë, fytyrën e tij, sytë shpotitës prapa syzeve me skelet të trashë, dorën e tij të zbehtë dhe disi nervoze, me të cilën kishte shkruar me shpejtësi e shtrembtas atë numër telefoni. Tërë ditën mendja më rrinte te telefoni. Po sikur ta merrja? Po sikur ai të më ftonte t'i vija? Po sikur, po sikur. Telefona në Tiranë në atë kohë kishte fare pak dhe kabinat telefonike në rrugë nuk ekzistonin, veçse në zyrën e postës dhe, natyrisht, te drejtoresha e tmerrshme, Xhevo. Në konvikt, tërë pasditet, bashkë me Meri shpresë se mos e gjenim ndonjë çast të lirë. Por zyra ishte gjithmonë me drejtoreshë brenda dhe fytyra e saj ishte gjithmonë po aq e rreptë. Telefon kishte edhe te dezhurni i fakultetit dhe te tezja ime e vogël, Liria, ku shkoja të bujtja nganjëherë. Megjithatë, asnjëherë s'guxova ta bëja këtë hap. Kisha frikë, kisha ndrojtje dhe, sidomos, i trembesha një propozimi, për të shkuar tek ai. Ndërkaq, mendja më punonte veç aty. Aq shumë isha magjepsur pas tij, sa s'u përmbajta dhe i fola edhe të fejuarit për të. Mbaj mend se, tek i flisja me entuziazëm se sa i jashtëzakonshëm më qe dukur Is, sytë e të fejuarit u pikëlluan. Ai s'foli asnjë fjalë dhe, me sa duket, për të më dhënë të kuptoja pakënaqësinë e tij, disa ditë nuk erdhi fare në konvikt. Por unë, e dalldisur siç isha, as nuk e vura re fare këtë mungesë dhe vetëm kur ai erdhi më në fund dhe, me fjalë të matura më shprehu qejfmbetjen e tij për këtë admirim të tepruar, mbeta me të vërtetë e habitur. Për mua ishte fare e pakuptueshme që dikush mund të mbetej indiferent para ekzistencës së një mrekullie të atij lloji, siç ishte në vetvete Is. Por në atë kohë isha shumë e re dhe nuk e njihja mirë se çfarë ishte xhelozia dhe ç'forcë shkatërrimtare kishte ajo në jetën e njerëzve.

Pikërisht në këtë kohë doli libri me poezi i tij Shekulli im. Dalja e librit u mor vesh që në orët e para në fakultet. Shumica e studentëve lanë leksionet e mëngjesit dhe shkuan për ta blerë. Shumë shpejt u dëgjua të flitej prej tyre me entuziazëm për të, duke



e quajtur një vepër novatore. S'do mend që unë e Meri L. ishim ndër të parat që vajtëm në librarinë e qendrës së Tiranës. Mbaj mend që libraria ishte e mbushur plot dhe njerëzit e kërkonin me etje këtë libër. Ne të dyja mblodhëm paratë e pakta që kishim dhe e blemë bashkërisht. Me librin në dorë u kthyem si të ndërkryera në konvikt. Meri L. u tregua bujare dhe ma la librin ta lexoja e para.

Mbeta krejt e mahnitur. Libri ishte gjithë nerv e rebelizëm artistik.

Me duart që më dridheshin nga padurimi e shfletova edhe një herë krejt, për të gjetur poemën Antiqiella, të shkruar në Rigë të Letonisë, për të cilën ishte hapur një legjendë në Tiranë. Por nuk e gjeta. Në të vërtetë, siç mora vesh më vonë, kjo poemë ishte botuar me një titull të ndryshëm e të rëndomtë, që nuk ngjante fare me stilin e tij: Paqen do ta imponojmë. Ishte i vetmi lëshim që Is iu kishte bërë vërejtjeve të redaktorëve të shtëpisë botuese, të cilët, me të drejtë, ishin trembur ta botonin ashtu siç ishte.

Libri zgjoi një reagim të fortë në të gjitha shtresat e shoqërisë. Ai ishte njëfarë sfide arrogante kundër poetikës së kohës. Ishte i mbushur me figura të guximshme, ekstravagante. "Mizat ulen me zukamë në vijat e pizhameve, si avionët në pistat e aeroporteve", thuhej në njërën nga vjershat. Dhe më poshtë:

Mos më lër kurrë, o moj botë e madhe
Mos m'i mbyll kurrë portat.

Më parë, ai i kishte mahnitur lexuesit me një cikël vjershash botuar në Zërin e Rinisë, midis të cilave ishte poema Vjeshtë në Tiranë, që niste me vargun e famshëm "Pa formë është qielli, si tru idioti". Shekulli im ishte i mbushur me margaritarë të tillë të pazakonshëm, të rrezikshëm, që e prishnin amullinë e letërsisë konformiste. Sidomos poema Rrugëve të Moskës, një poemë tërësisht intime, ishte një gjë e paparë në letërsinë e re e të kontrolluar shqipe.

Merrej me mend që libri nuk do të pritej mirë. Ashtu ndodhi vërtet, por kritikat bënë efekt të kundërt. Jo vetëm unë me Meri L., kuptohet, që brenda pak ditëve e kishim mësuar thuajse gjithë librin përmendsh, por studentët në përgjithësi i citonin kudo vargjet e tij nëpër auditore. Pëlqeheshin sidomos metaforat e guximshme, si ato ku fanatikët e artit krahasoheshin me fanatikët në jetë, ata që iu gëzoheshin virgjërisë së vajzave si pijanecët shampanjës së pahapur etj.

Si shumica e vajzave të reja, unë përpiva me vrap sidomos vjershat e dashurisë. Ishin të shumta, disa me iniciale, gjë që ishte e rrallë në letërsinë shqipe. Shumica iu kushtoheshin vajzave ruse dhe unë për herë të parë në jetën time provova një xhelozi të mprehtë për heroinat që fshiheshin pas atyre inicialeve. Përmendeshin rrugë me drita, bare nate, ashensorë, puthje, humbje virgjërie, dashuri në shtrat, me "një mollë në komodinë gjysmë e ngrënë". Veçanërisht vargjet kushtuar një vajze letoneze me emrin Brigite, që fillonin:

Retë ikin drejt Suedisë.
Së shpejti do t'ik dhe unë Brigita,
Në të kundërtin drejtim të reve.

na e ndiznin keq fantazinë.

Të gjitha këto ishin gjëra të reja, eksitante në letërsinë shqipe. Gjithë libri dukej i pabesueshëm, gati-gati një gabim në sfondin e kohës.

Më pas Is do të më shpjegonte se ky libër kishte parë dritën e botimit falë guximit të Drago Siliqit, mikut të tij të ngushtë, i cili, për fat, sapo ishte emëruar drejtor i shtëpisë botuese "Naim Frashëri", shtëpia botuese kryesore e vendit.

Disa muaj më pas do të mësoja diçka që, ndonëse kishte lidhje me Shekulli im, nuk e dinte pothuajse askush. Me postën që ende punonte me jashtë, mbërriti nga Moska një libër poetik i Is, përkthyer e botuar në rusisht. Libri titullohej Lirika dhe ishte libri i parë i tij në botën e jashtme. Ishte viti 1961 dhe, ngaqë marrëdhëniet midis Tiranës dhe Moskës po shkonin drejt prishjes së plotë, shtypi shqiptar nuk shkroi asnjë rresht për këtë botim.

Is do të ma tregonte si kuriozitet në një nga takimet tona të para dhe mua m'u duk si e pabesueshme të shikoja një Shekulli im të dyzuar në version rus. Libri ishte paraqitur në shtëpinë botuese ruse qysh në fund të vitit 1959, por botimi ishte zvarritur për shkak të vërejtjeve të shumta. Me fjalë të tjera, kritikat që i ishin bërë në Tiranë, i qenë bërë përpara në Moskë. Libri kishte dalë më në fund më 1961, i pajisur me një "parathënie distancuese", siç bëhej me shkrimtarët e botës Perëndimore, të cilët, ndonëse botoheshin, shtëpitë botuese sovjetike vinin në dukje në parathënie rezervat që kishin për shkrimtarin.

Por këto do të ndodhnin më pas, kur të afrohesha me të. Tani për tani s'dija asgjë, madje nuk dija nëse do të ndodhte ndonjë ditë afrimi ynë.

(Marrë nga libri : Helena Kadare, « Kohë pamjaftueshme », *kujtime, Onufri, Tiranë, 2011)*

Sot në libraritë kryesore të Tiranës

KADARE

dialog me Alda Bardhylin

"KOHË PËR RRËFIM"

Në pak javë, ju do të mbushni 85 vjeç. Si ndiheni?

Ndihem mirë, nuk kam ndonjë ankth, nga ato që kam lexuar në biografi të ndryshme të shkrimtarëve, që njihen ndryshe si "kriza e krijimit", e të tjera të ngjashme. Kur krijimi letrar, "puna letrar" ecën mirë, mendoj se gjithçka tjetër ecën mirë te shkrimtari. Kur ajo jep shenjat e ngecjes, atëherë është vërtet një shqetësim, i lehtë për t'u konstatuar, por shumë i vështirë për t'u ndrequr. Kjo hyn në ato të fshehta që shkrimtari jo vetëm nuk i shpjegon dot, por dhe nuk ia zbulon dot vetes. Ka në të diçka të pagabueshme. Kur themi të pagabueshme, do të thotë dhe të pandreqshme kur është për keq, apo të shkatërrueshme kur është për mirë.

Është ndoshta kjo, që në një përfytyrim universal botëror, çështja e krijimit është komode të quhet si hyjnore. Është tepër naive si përftim, por ka në të një të vërtetë që vështirë të zëvendësohet me një tjetër. Është ajo që quhet, në një përfytyrim popullor, "diçka që vjen nga lart". Kjo duket si fëmijërore, por është e vërtetë. Ka vërtet "diçka" që vjen nga lart. Por sa herë njeriu kërkon ta shpjegojë këtë gjë, nuk e gjen dot.

Duke u kthyer pas një kohe, si i kujtoni 50 vitet tuaja si shkrimtar?

Kanë qenë 50 vite të shqetësuara, po të përdorim një të folur të thjeshtë, me shumë telashe, shumë rreziqe, pritje, por në përgjithësinë e tyre janë vite të bukura. Fakti që ke krijuar, është gjë e bukur. Të bukura do të thotë të vërteta në bukurinë e tyre. Shkrimtari e ndien në mënyrë të pagabueshme, kur ajo që krijon është e vërtetë, është art dhe për artin vështirë se mund të gjendet diçka që mund ta shformojë.

Nuk mbaj mend të kem krijuar diçka që të ketë qenë e huaj për qenien time të brendshme. Edhe në pjesët kur kam qenë i kujdesshëm, kur kam qenë i kujdesshëm për arsye tashmë të njohura, ka një fazë të padiskutueshme të vërtete, një thelb që nuk prishet, dyshimi për atë që po e quaj prishje të thelbit. Është më i frikshmi për shkrimtarin.

Flitet shpesh për detyrimet e letërsisë konformiste, për krijimtari që është krijuar nën këtë trysni të detyrimeve...

Mund të them me ndërgjegje të plotë se nuk kam një kujtim të tillë të hidhur.

E dini që jeni një shkrimtar i madh? Çfarë ndieni kur dëgjoni shpesh këtë cilësim?

As nuk më ngazëllen dhe as më tremb. Në këtë rast fjala shkrimtar i madh mund të zëvendësohet me fjalën "shkrimtar i vërtetë". Unë jam shkrimtar, në kuptimin e plotë të fjalës. Në këtë cilësim zotëron ana pozitive që jam shkrimtar. Shpesh njerëzit, kur nuk u pëlqen një shkrimtar, nuk thonë ky është shkrimtar i keq, i zakonshëm apo i rëndomtë, por thjesht thonë: është shkrimtar. Po ta mendosh thellë është një mrekulli, kur profesioni në formulimin e vet e mbart të mirën, pozitiven. Shprehja është shkrimtar, është tamam shkrimtar, do të thotë se është shkrimtar i mirë.

Mendoj se për të gjithë ne krijuesit, shkrimtarët, ky është një gëzim i thellë, që na shoqëron të gjithë jetën. Për shkrimtarët e vërtetë ky është gëzim, por ka edhe anën e keqe të tij për shkrimtarët jo të mirë, dhe këtë ata e ndiejnë. Shkrimtarët e pakryer ndiejnë të keqen. Pra është një formulim që shkakton gëzim e vuajtje njëkohësisht. Kjo shprehje mua gjithë jetën më ka sjellë gëzim.

Erika Jong, një autore që më pëlqen shumë, shkruan për dëmin që i sjellin botës shkrimtarët apo artistët e pakryer, ose të parealizuar, te romani Frika e fluturimit. Nuk ka përbindësh më të madh se një shkrimtar i dështuar, thotë ajo...

Shkrimtarët e pakryer kanë dashur ta dëmtojnë artin botëror, por gjithashtu, pa dashur, s'e kanë dëmtuar dot. Bukurinë e të qenët, të ekzistencës, arti e ka brenda thelbit të vet dhe ky thelb do të gjejë patjetër mënyrën për t'u shfaqur. Në një vizion të përgjithshëm, nëse do të përfytyronim diçka që mund të përfshinte këtë thelb, ai është gjithmonë pozitiv. Ndoshta kjo që po them nuk është fort e qartë, por edhe pse e tillë, është e padëmshme.

Si i keni jetuar këto kohë zhvillimet globale, pandeminë?

I kam përjetuar natyrshëm. Nuk më kanë shkaktuar ndonjë shqetësim serioz, por kjo vjen sepse, për një shkrimtar, shqetësim serioz është gjithnjë ai që lidhet me krijimin. Këto travaja nuk kanë qenë asnjëherë penguese për procesin e krijimit. S'duhet harruar se, pjesa më e madhe e asaj që shkruhet në botë, harrohet. Ky është një shërim i natyrshëm i herëpashershëm, që e ka përbrenda kjo sferë dhe që e prodhon sa herë asaj i duhet. Mund të duket e pakuptueshme, por ndoshta, na lejohet ne shkrimtarëve që në bisedat tona të kemi disa herë një pakuptueshmëri të tillë.

Jeni admiruar, por edhe kritikuar shumë, po kaq shumë keni qenë temë diskutimesh mbi raportin tuaj me



regjimin, ndoshta dhe për njohjen tuaj ndërkombëtare. Si u përgjigjesh shumë njerëzve që u pëlqejnë ta shohin portretin tuaj me shumë fytyra?

Është e kuptueshme për mua, kështu ka qenë gjithnjë për shkrimtarët, siç janë ndonjëherë gjërat tepër të kuptueshme që ngjajnë të pakapshme. Shkrimtari shpesh qëllon që lodhet nga e pavërteta e gjërave dhe kjo lodhje është ndonjëherë e rrezikshme, kur ai mësohet me të dhe nis oqeani i madh i shpërfilljes, që është jashtëzakonisht i rrezikshëm.

Lëndoheni kur lexoni shkrime kundër jush?

Prej kohësh nuk lëndohem më, por edhe kjo nuk është gjë e mirë. Lëndimi është diçka e çuditshme, ka shumë fytyra, shumë pasoja, e një nga pasojat më të këqija të tij është shpërfillja. Unë nuk e kam të qartë ndonjëherë, nëse shkrimtari duhet të jetë shpërfillës apo përfillës.

"Nuk ka asnjë shkrimtar të vetëm që të heshtë. Nëse hesht, kjo do të thotë se nuk është shkrimtar i vërtetë. Nëse një shkrimtar i vërtetë hesht, atëherë kjo do të thotë se ka ardhur fundi..." Bulgakov i shkruante kështu Stalinit në një letër, ku i lutej për leje që të linte disa kohë Rusinë, duke e parë figurën e shkrimtarit si tepër të rëndësishme dhe aktive në debatin publik. Çfarë ka bërë që ky rol të zbehet sot gjithnjë e më shumë? Dhe raporti i shkrimtarëve sot me pushtetin nuk është më i dikurshmi?

Në të vërtetë është një çështje shumë e ndërlikuar, e parrahur thellësisht nga mendimi letrar dhe ka të bëjë me një kundërthënie që e ka krijuar koha dhe zhvillimi. Sot, për përhapjen e librit ka mjete të jashtëzakonshme të zhvilluara dhe për çudi bie në kundërshtim me aureolën e shkrimtarit, e cila në vend se nga ky reklamim i tepruar të fitojë, ka gjasë të humbasë. Është një nga misteret e tërheqjes së letërsisë, nga masa e pafundme e njerëzve.

Në të vërtetë, sa për raportet shkrimtar-shtet janë më të ndjeshme sot se përpara, megjithëse përshtypja është e kundërta. Mendoni vetëm realitetin e librarive. Ka miliona librari në botë, ku lexuesi është ballë për ballë librit, ku bëhen miliarda biseda për librat që shiten, ndërsa po të marrim një shembull nga antikiteti grek, përkitja fizike e publikut me autorin bëhej zakonisht në teatër, tani ajo ka qindra mënyra.

Shkatërrimi i botës, ju ka shqetësuar? A mendoni se do të vijë së shpejti? Kjo është pyetja që dy vite më parë, Filip Roth ia drejtoi Milan Kunderës. Do të doja t'ju bëja të njëjtën pyetje ju?

Ndjenja e shkatërrimit është e pranishme në jetën e një letërsie. Është një ndjesi që vështirë t'i përcaktosh emrin. Por, pa këtë përmasë, nuk përfytyrohet dot që mund të ketë art dhe letërsi.

Globalizmi, teknologjia, pandemia e kanë çuar kulturën në një formë të re komunikimi. Sa mendoni se letërsia do t'u rezistojë këtyre lëvizjeve. Si mendoni që ajo do të jetë pas 50 vitesh?

Në çdo fazë të tij arti ka zonat e lehta që duken të tilla, ose zona të thella të ngrysura që janë, ose që ngjajnë të tilla. Por vlerat e tij janë të pacenueshme nga cilado lëvizje.

Si e mendoni lexuesin e shekullit XXII përballë librave tuaj?

Nuk e kam të lehtë ta mendoj, por mendoj kryesoren, se do të ekzistojë lexuesi im edhe pas kaq kohësh.

A keni shkruar një vepër politike?

Jo, asnjëherë! Nuk mendoj se ka qenë ndonjëherë kështu dhe nuk do të jetë asnjëherë kështu.

Si e shihni politikën tani në Shqipëri?

Nuk kam ndonjë viziton të veçantë për të.

Si ndiheni ndaj kulturës europiane. Ezra Paund e quante atë "barbare".

Nuk e kuptoj ndryshe kulturën shqiptare përveçse europiane dhe ajo është fytyrë e natyrshme e saj, sikurse e çdo letërsie në përgjithësi. Në Shqipëri janë shkruar e botuar

libra në çdo kohë, dhe libri ka qenë një gjë e natyrshme e shoqërisë shqiptare, pavarësisht se sa ishin botimet ose shpeshtia e botimeve.

Varet si e përdor fjalën "barbare", në këtë rast, në mendjen e tij, që mund të ishte e vjetër, primitive, e pagdhendur etj., etj.

Thagma e një Shqipërie europiane përshkruan të gjithë veprën tuaj. Si e shihni sot Europën?

Është një problem i përjetshëm, pak a shumë vazhdon. Mendoj se vetë Europës i duhet një sforcim për të ruajtur natyrën e saj. Kur themi Europa është e kërcënuar mund të përdorim shprehjen: Europa, ndër të tjera, e vetëkërcënuar.

Si ta lexojmë fjalën vetëkërcënim?

Në prirjen e gjërave që s'kam dëshirë t'i mendoj, por që janë shumë këmbëngulëse në të keqen e tyre.

Ku e shihni fatin e Perëndimit?

Në shprehjet bota perëndimore, prirja perëndimore, kam përshtypjen se ka gjithnjë diçka të pasaktë.

A e ndryshoi komunizmi pikëpamjen tuaj për botën?

Nuk besoj.

Në qëndrimet ndaj kulturës e letërsisë shqipe nuk përjashtohet vlerësimi ose jo i gjuhës shqipe. Shpesh në këto qëndrime ka himnizim, e shpesh injorim të saj. Cili është opinioni juaj ndaj këtyre qëndrimeve?

Po, është e vërtetë, që për gjuhën shqipe janë shfaqur mendime nga më kundërthënëset, gjë e njohur kjo për gjuhët e vendeve të vogla. Mendimi im për këtë është përcaktuar prej shumë vitesh dhe ka qenë i pandryshueshëm. Shqipja është një gjuhë serioze, në mënyrë të padiskutueshme, me një histori të faktuar bindshëm, me botime të hershme, që do ta nderonin çdo kalendar historik të çdo gjuhe. Teprimet në dy skajet: himnizimi, ose shpërfillja ndaj saj, janë të kuptueshme në rastet e një gjuhe të tillë. Përdoruesit e saj, shkrimtarët, jam i bindur që ndihen mirë, për të mos thënë shumë mirë me të. I them këto fjalë si njeri i kulturës dhe sidomos si përdorues profesionist i kësaj gjuhe. Mendoj se as përdorimi, as himnizimi i tepruar i saj dhe as shpërfillja ndihmojnë në këtë të vërtetë të saj.

Ju vetë, a jeni ndier ndonjëherë i ngecur në kufizimet e gjuhës?

E them pa asnjë paragjykim, se nuk kam njohur kurrë një ngecje të tillë. Mendoj se trajtimi i mendimit në gjuhën shqipe është shumë i lehtë dhe shumë i natyrshëm për shkrimtarët. Kështu ka qenë që në fillimet e botimeve të para të saj në mesjetë.

Cili ka qenë ankthi juaj më i madh si shkrimtar?

Të shkruaja gjëra që nuk kishin mister, që nuk kishin atë tërheqjen e fshehtë, që nuk kishin mjegull t'i mbështillte. E, për fat të keq, të gjitha ato që sugjeronte letërsia jonë, ishin të tilla, sterile. Shpirti im ishte krejtësisht i ftohtë ndaj tyre.

A ka një kohë kur keni qenë vërtet i lumtur?

Kam qenë i lumtur herë pas here. Në mënyrë të padiskutueshme i lumtur sa herë që një aventurë shkrimore përfundonte pa dëmtim fatal. Ato të ashtuquajturat dëmtime "si shkrimtar i borgjezisë etj.", nuk ishin më një gjë e keqe. Isha mësuar me to, e dija që portreti im nuk ishte i ndarë nga këto ngjyra të muzgëta. Fatkeqësia më e madhe e mundshme, më dukej ndalimi i veprës sime.

Ju torturonte ky mendim?

Nuk më torturonte, por më shkonte ne mend. Kisha një besim që letërsia nuk të linte në baltë kurrë. Kisha një lidhje magjistare me ithtarët e letërsisë. Kufirin e fundit kisha një shikim jo të errët për atë ndriçimin e saj, që ai do të ekzistonte gjithmonë.

Ju tremb ikja e viteve? Ju tremb vdekja?

E kam përfytyruar në mënyrë krejt të lehtë e pa dramacitet. Nuk më tremb. Vdekja bën pjesë te jeta e shkrimtarit, është e pandarë dhe është e kuptueshme, nuk është për figura artistike, është jeta jote pa praninë tënde në botë, që shumica e njerëzve nuk e kanë. Ka një aleancë të letërsisë me vdekjen në jetë, në ndërthurjen e tyre.

E keni menduar ndonjëherë ikjen tuaj?

Më duket sikur e di! Zakonisht shkrimtari e di. Në mendjen e shkrimtarit është në skenën e ngjarjeve, që janë librat e tij. Analiza e veprës së një shkrimtari kur shkruhet për të, i ngjan një periudhe që ai nuk është i pranishëm. Është stili i vdekjes.

Besoni në një jetë të përtejme?

Nuk besoj dhe, nga ana tjetër, në mendjen time dyzimi nuk është i pranishëm, as si dilemë dhe as si pyetje. Është e vështirë të kuptohet, dua të them. Më duket se nuk ka ndonjë ndryshim të madh.

KADARE: ËSHTË E PAKUPTIMTË AJO LETËRSI QË QËNDRON JASHTË KOHËS SË VET

(Pjesë nga intervista ekskluzive e Ismail Kadaresë dhënë gazetës "Rilindja", Prishtinë, e mërkurë 31 dhjetor 1980)

Dyzet vjet më parë, saktësisht në vjeshtë të vitit 1980 në "Rilindjen" e Prishtinës u botua kompleti i veprave të Ismail Kadaresë në 10 vëllime. Atëbotë, Kadare u ftua që të bënte një vizitë në Kosovë dhe më këtë rast zhvilloi takime të shumta me shkrimtarë dhe personalitete të rëndësishme të kulturës në Kosovë. Nga rubrika e kulturës e gazetës "Rilindja" isha caktuar të bëja një intervistë me Ismail Kadarenë, bëra një numër pyetjesh, të cilat u kontrolluan nga kryeredaktori Fadil Bujari dhe nga drejtori "Rilindjes", Rexhep Zogaj, të cilët e miratuan listën e pyetjeve. Më pas ishte Azem Shkreli ai që i mori pyetjet, me idenë që t'ia jepte Kadaresë, meqë ai ishte shoqëruesi i tij. Ndërkohë, Kadare u largua nga Prishtina pa kthyer përgjigje për intervistën, por ndodhi që në disa ditë më vonë në Lidhjen e Shkrimtarëve në Tiranë u mbajt një konsultë për romanin shqiptar, ku ishin të ftuar edhe shkrimtarë nga Kosova. Unë iu bashkëngjita grupit të shkrimtarëve, jo si shkrimtar dhe autor romanesh, por si gazetar i "Rilindjes", që ndiqja aktivitetet e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Në Tiranë u takuam disa herë me Kadarenë, në hotel "Dajti", në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe në shtëpinë e tij. Atmosfera ishte shumë miqësore dhe mbase kjo mund të ishte arsyeja pse Kadare iu kthye intervistës dhe bëri ca përgjigje të drejtpeshuara, të cilat, mbi të gjitha, kishin vendosur një raport të çiltër me shkrimtarët dhe lexuesin e Kosovës, i cili për më shumë se pesëdhjetë vjet do t'i mbetet besnik këtij shkrimtari.



Kadare dhe Mehmet Kraja gjatë intervistës në Hotel "Tirana" (foto: Nazmi Rrahmani)

Me ndonjë rast kritika letrare ka theksuar se romanet tuaja ndërtohen mbi raportin bota-Shqipëria dhe se këtu krijohet një konflikt i vazhdueshëm, që përsëritet nëpër kohë. A mendoni se lexuesi i huaj do ta kuptojë drejtë këtë raport?

Kjo është një materie artistike jo e shpikur, por e gjetur prej meje në historinë e vendit. Do ta kuptojë drejt ose jo, lexuesi i huaj s'ka shumë rëndësi. Rëndësi ka që ajo të pasqyrohet drejt. Në qoftë se do të ndodhë kështu, gjithmonë do të gjenden ata që do ta kuptojnë.

Në veprat tuaja shpesh iu bëni jehonë ngjarjeve të kohës. A mendoni se duhet një distancë më e madhe, në mënyrë që shkrimtari të japë gjykimin e vet ato ngjarje?

Mendoj se kjo varet nga ngjarja. Por këtu duhet thënë se nuk është vetëm koha materiale që përbën distancën.

Po shkrimtari a duhet të krijojë distancë me politikën?

Mendoj se çdo e ashtuquajtur distancë me politikën s'është veçse njëfarë politike.

Lidhur me metodën e shkrimit tuaj në prozë një pyetje: metoda e realizmit socialist shpesh ka sjellë klishe dhe shabllone në letërsi. Me veprën tuaj nuk ka ndodhur kështu...

Ja një pyetje që pothuajse nuk mungon kurrë në intervistat me shkrimtarët që aplikojnë realizmin socialit. Si e tillë ajo mund të quhet pyetje-klishe. Më falni, nuk e kam në kuptim të keq këtë gjë. A kane krijuar klishe dhe shabllone shkrimtarët e realizmit socialist? Po i përgjigjem thjeshtë: po, kanë krijuar. Natyrisht që kanë krijuar. Do të ishim idealistë po të pretendonim të ndodhte ndryshe.

TAKIME

ËSHTË E PAKUPTIMTË AJO LETËRSI QË QËNDRON JASHTË KOHËS SË VET

● Intervistë ekskluzive e Ismail Kadaresë dhënë »Rilindjes«

Ismail Kadare

Kohë më parë për një vizitë disaditëshe në Kosovë qëndroi shkrimtari i njohur Ismail Kadare. Me këtë rast ai pati shumë takime krijuese me punëtorë të artit e të kulturës, me lexues të shumtë dhe ky ishte rasti i parë që ky shkrimtar u gjend mes një publiku, i cili e lexon, e vlerëson dhe e çmon.

Me këtë rast Ismai Kadares i dha »Rilindjes« një intervistë ekskluzive, tekstin integral të së cilës po e botojmë me këtë rast.

● Shoku Ismail, këtë bisedë do ta zëmë nga poezia, se në këtë zhanër së pari jeni realizuar si shkrimtar. Kam përshtypje se shumë tema-ide më parë i keni fiksuar në poezi, e nga ana tjetër, duket se lidhmëria midis prozës dhe poezisë në krijimtarinë tuaj është

poetësh të rinj, janë krijues shumë të mirë, të freskët, dhe faktin qe, siç thoni ju, nuk kemi një ndërrim aq të shpejtë brezash, dhe që këta poetë janë të lidhur me poezinë e viteve 60, ashtu siç qe e lidhur ajo me poezinë e mëparshme, unë e quaj një gjë pozitive.

● Në bisedat, që krijuesit tanë kanë pasur me ju, fitohet përshtypja se e përcillni me kujdes atë që krijohet sot në Kosovë. Sa i ofrohet ajo lexuesit në Shqipëri dhe cili është mendimi për të?

– Përherë e më tepër letërsia shqipe-që krijohet në Kosovë është bërë e po bëhet e njohur në Shqipëri. Dhe këtu nuk është fjala për rrethe të caktuara letrarësh e intelektualësh, por për masën e gjerë të lexuesve, duke filluar nga lexuesit e kryeqytetit e të qyteteve të tjerë e gjer në zonat më të largëta. Ky lexues e pret me interesim të veçantë, me kureshtje dhe ngrohtësi krijimtarinë e shkrimtarëve të Kosovës. Qindra mijëra kopje librash të

Kështu ka ndodhur gjithmonë dhe kështu do të ndodhë gjithmonë, çdo metodë artistike, çdo metodë vitale artistike, krijon, krahas vlerave të saj, edhe klishetë e saj. Kjo është e natyrshme. Ajo që s'është e drejtë kur flitet për shabllonet dhe klishetë është fakti që ato i atribuohen vetëm realizmit socialist. Kjo s'qëndron kërkund. Realizmi socialist s'ka mbushur as shekullin kurse klishetë dhe shabllonet letrare janë të vjetra sa bota. Në krahasim me realizmin socialist, letërsia borgjeze, shkollat e ndryshme të saj, kanë krijuar dhjetëra herë, qindra herë më shumë klishe dhe shabllone. Madje, do të thoshja se disa nga shabllonet që vazhdojnë të jetojnë në letërsinë e shkrimtarëve të realizmit socialist janë të huajtura për fat të keq nga letërsia borgjeze. Që të kthehemi te klishetë: pak klishe dhe shabllone ka romantizmi evropian, sentimentalizmi, madje edhe realizmi kritik-lavdia e letërsisë borgjeze? Veç kësaj, ku është marrë kjo e drejtë që realizmi socialist të përfaqësohet vetëm nga shkrimtarët difektorë të tij? Shkrimtarë me aftësi të kufizuar ka pasur dhe do të ketë gjithmonë, por metodat letrare nuk janë identifikuar kurrë me ta. Një filozof ka thënë se shpejtësia e një flote është baras me shpejtësinë e anijes më të ngadaltë, por në letërsi nuk ndodh kështu, përkundrazi. Këtu s'duhet harruar se dy nga shkrimtarët më të mëdhenj të shekullit tonë, Majakovskin dhe Brehtin, i ka dhënë pikërisht realizmi socialist.

Në bisedat që krijuesit tanë kanë pasur me ju, fitohet përshtypja se e përcillni me kujdes atë që krijohet sot në Kosovë. Sa i ofrohet ajo lexuesit në Shqipëri dhe cili është mendimi për të?

Përherë e më tepër letërsia shqipe që krijohet në Kosovë është bërë dhe po bëhet e njohur në Shqipëri. Dhe këtu nuk është fjala për rreth të caktuara letrarësh e intelektualësh, por për masën e gjerë të lexuesve, duke filluar nga lexuesit e kryeqytetit e të qyteteve të tjerë e gjer në zonat më të largëta. Ky lexues e pret me interesim të veçantë, me kureshtje dhe ngrohtësi krijimtarinë e shkrimtarëve të Kosovës. Qindra mijëra kopje librash të autorëve kosovarë qarkullojnë në Shqipëri. Në revistën "Les lettres albaniases" që ne botojmë frëngjisht për botën e huaj, gati në çdo numër ka autorë nga Kosova.

Gjatë qëndrimit tuaj në Kosovë keni pasur kontakte me krijues dhe punonjës të kulturës, pastaj me lexues, të cilët janë të shumtë. Me ç'përshtypje po largoheni që këtej?

Po largohem me përshtypjet më të bukura, me një pasuri të madhe, tepër të madhe që e marr me vete dhe për të cilën ju falënderoj shumë, ju falënderoj shumë.

Intervistoi: Mehmet KRAJA

JOACHIM RÖHM

Kadare ka ruajtur integritetin dhe dinjitetin e letërsisë shqiptare gjatë komunizmit

I ftuar nga botuesi Bujar Hudhri për të kontribuar në një numër special të revistës ExLibris kushtuar ditëlindjes së 85-të të shkrimtarit të madh Ismail Kadare, pyes veten se çfarë do të ishte ajo që do të kisha për të thënë pikërisht unë, përkthyesi e veprave të tij në gjuhën gjermane për afro dyzet vjet. Mund të flisja për përvojat e fituara në përkthimin e një numri mjaft të madh të romaneve, novelave, tregimeve, eseve dhe poezive nga dora e tij, mund të tregoja për përshtypjet e mia nga takimet e shumta që kishim gjatë asaj kohe të gjatë, me rast të aktiviteteve letrare në botën gjermanishtfolëse, të turneve leximi që kemi bërë bashkë në Gjermani, Austri dhe Zvicër, por edhe familiarisht. Mirëpo, hapësira që kam në dispozicion nuk mjafton aspak për të bërë diçka të tillë.

Prandaj mendohem dhe i bëj vetes pyetjen: Sa i përket veprimtarisë së Ismail Kadaresë, çfarë është më e rëndësishmja, ajo që – nga kendveshtrimi im – duhet thënë patjetër? Dhe arrij në këtë përgjigje:

Duke mos nënvleftësuar veprimtarinë e tij pas vitit 1992, mendoj se merita më e madhe e Ismail Kadaresë është ajo se me krijimtarinë e tij në kohën e errët të sundimit komunist ka mbrojtur dhe ruajtur integritetin dhe dinjitetin e letërsisë shqiptare.

Jam i vetëdijshëm se këtu mund të hasem me kundërshtime. Është absolutisht legjitime të diskutohet për rolin dhe përgjegjësinë e krijuesve në regjimet totalitare. Por në qëndër të kesaj debate duhet të jetë krijimtaria e tyre. Sipas bindjes sime në thelb ka tre kategori krijuesish në sistemet totalitare: apologjetët e padenjë dhe palaçot oborri të regjimit, luftëtarët kokëkrisur të së vërtetës, të cilët zakonisht paguajnë shtrenjtë për guximin e tyre, dhe ata që arrijnë në një farë modus vivendi për të ruajtur kushtet për të vazhduar punën e tyre. Të parët nuk vlejnë as të përmenden, të dytët meritojnë gjithë respektin dhe dashurinë tonë, ndërsa të tretët mirëkuptimin tonë kritik: duhet të gjykohen pas veprave të tyre.

Në kushtet e regjimit jashtëzakonisht të egër dhe shpirtlig komunist në Shqipëri, tani citoj veten, Ismail Kadareja është treguar absolutisht mospërfillës ndaj

dogmës estetike zyrtare të realizmit komunist, duke krijuar vepra letrare me peshë botërore.

Kjo nuk ishte aspak e lehtë. Për pushtetarët komunistë, realizmi socialist nuk ka qenë thjesht një teori letrare, një doktrinë midis doktrinave, por një armë vrastare në fushën e estetikës. Vazhdoj të citoj veten: Elemente përbërëse e një vepre prototipike të realizmit socialist janë denoncimi, ndjekja, diskriminimi, burgosja dhe shpesh herë edhe eliminimi fizik i të ashtuquajtur "armiqve të klasës"; arsyetimi ose justifikimi i poshtërimit të skajshëm të një numri të madh njerëzish të pafajshëm vetëm për shkak të rrethanave të tyre familjare, botëkuptimore, seksuale e kështu më radhë, të cilëve u mohoheshin të drejtat elementare e njeriut; thjeshtëzimi deri në karikaturë të marrëdhënieve shoqërore (o mik, o armik); etablimi i urrejtjes si element baze i shoqërisë dhe politikës edhe në letërsi; justifikimi i një diktature të përgjakshme të një pjese të popullsisë mbi tjetrën (në teori) gjegjsisht të (udhëheqësve të) partisë mbi gjithë popullsinë (në praktikë), e të tjerë.

Pra, mospërfillja ndaj kësaj doktrine përbënte një sfidë ndaj regjimit komunist. Ismael Kadareja, duke mos lejuar që hija e dogmës komuniste t'ia errësonte veprën, i ka provuar botës që letërsia shqiptare ishte në gjendje t'i bënte ballë diktaturës totalitare dhe meritonte një vend të nderuar në tempullin e letërsisë ndërkombëtare. Kjo nuk është pak.

Urime për ditëlindjen e 85-të dhe një jetë të gjatë.

DIPTIK ME KADARENË

Nga Visar Zhiti

Vepra kadareane doli në kohë të vështira, kur Shqipëria *ishte pjesë e veçantë në perandorinë komuniste gjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit XX dhe vuante diktaturën më të egër si dhe pasojat e saj deri më tani,* në fillimet e shekullit XXI.

Romanet e Kadaresë, poezia e tij më parë, u bënë prijëtare të letërsisë së re shqipe, madje dhe sunduese, kur letërsia e traditës pothuajse ishte e ndërprerë, shumë autorë të saj dënoheshin *dhe me burg, madje dhe me pushkatime, ndërsa letërsia botërore e shekullit XX, arritjet dhe risitë nuk lejohej* të *vinin. Kadare i përbashkoi ato duke krijuar një epikë moderne, magjepsëse.*

*Në gjeneratat, që vinin pas asaj të fitimtarëve, si "breza të humbur", ai pati një ndikim të pa zakontë. Kam shkruar se Kadareja na m*ësoi *atehere* t*ë lexonim letërsinë…*

Dukuria "Kadare" është ndër më komplekset në letrat tona*, ndër më të rëndësihmet në* të gjitha kohëra*t, po k*ështu dhe ndër më të *njohurat në botë si letërsi e dalë nga Shqipëria. Ndoshta jo vetëm prej fatit tim, nuk mund* *të rri pa thënë se n*ë këtë aksion zënë vendin e tyre dhe ish të burgosurit*, kundërshtarë të regjimit, përkthyes* të tij*, si për të na nëpërmendur lidhjen metaforike mes penës dhe prangave. Ata, pa emër, e përkthenin Kadarenë* në fre*ngjisht, në anglisht,* në italisht, etj*, ku shkëlqeu Jusuf Vrioni. Kadare lexohej me ëndje dhe në burg, ku, nëse një pjesë e shikonin si shkrimtar të angazhuar, të tjerë zbulonin tek ai, në mos kundërshtinë e hapur, mos-honepsjen ndaj mediokritetit dhe dogmave* të socrealizmit*. Në fund të fundit duhet* të mëso*hemi* të *mbrojmë shkrimtarin. Dhe veprën. Për të cilën vendosin lexuesi dhe e ardhmja.*

Edhe unë kam lidhjet e mia me veprën dhe me shkrimtarin Kadare. Dua të sjell këtu dy pasazhe të pakta nga ferri im dhe jashtë tij, një dëshmi imja, që...

Në hetue-Zi:

...Minjtë po vinin drejt meje me nga një copëz metafore në gojë.

- E ke njohur Ismail Kadarenë?

Shtanga. Me një si shpresë të vagëlluar, s'e di pse, por që zgjati më shumë se një grimë, se tani do të isha më i mbrojtur. Ngaqë e ndieja apo e dëshiroja se aq lart, në katet që nuk i pushtonin dot, ata s'mund të prishnin gjithçka?

- Ismail Kadarenë e njeh e gjithë Shqipëria, - iu përgjigja pyetjes, - dhe bota, - shtova. Por u pendova se mos më thoshte: po ku e di botën ti? Ja, nga ato që botohen, do të thosha. I qetë aq sa mundej. Dhe sa më i përgjithshëm, çka e nervozonte menjëherë hetuesin.

- Ti, ti a e njeh? - bërtiti. - Pse u bën bisht pyetjeve? Thuaj po ose jo. Pa komente. Komentet i bëjmë ne.

Më kapën përsëri drithmat. E gjitha kjo u përzie me makth: barbaria s'ndalet, mendova... Hetuesi shtypi butonin në anë të tryezës... dhe u shfaq menjëherë te dera polici në qëndrim gatitu.

- Kush të tha t'ia heqësh prangat këtij? Nuk e meriton. Vërja!

- Si urdhëron!

- ...Kthehemi te çështja. Po e përsërit. E ke njohur Ismail Kadarenë, i pandehur?

- Unë po.

- Po ai?

U rrëqetha. Intonacioni ishte i tillë, sikur donte të thoshte: po ai, i pandehuri tjetër? Por ai a nuk është juaji, desh thirra.

- Jo. S'kish pse të më njihte.

- Ti gënjen. Nuk je i sinqertë. Mbi ty do të rëndojnë të gjitha. Po mblidhen e po mblidhen dhe s'do t'i mbash dot. Në ditarin tënd ke shkruar se e ke parë Kadarenë në Lidhjen e Shkrimtarëve.

- Është normale, ku duhej ta shihja?...

...

- Meqenëse ti je armik dhe e kupton më mirë se ne, - vazhdoi (një herë tjetër, edhe ai i pagjumë, - duam të na komentosh se ç'do të thotë Ismail Kadareja në romanin e tij "Dimri i madh" me atë skenën kur ai malësori zbret nga Bjeshkët e Nemuna e do që të takojë Enver Hoxhën në Tiranë, dhe roja me automatik e ndal ashpër, ndërsa binte shi?

Ej, o Zot, po unë kam dimrin tim, për Kadarenë më kanë arrestuar këta? E si t'u përgjigjesha, veçse me gjuhën e tyre, edhe esëll, edhe përgjumësh, se ju vetë thoni, ashtu siç porosit Partia, se ka armiq, të jashtëm e të brendshëm, dhe udhëheqësi duhet mbrojtur. Ushtari përfaqëson diktaturën e proletariatit. Arma në duart e tij simbolizon, jo, jo nuk simbolizon, s'jemi në simbolizëm këtu, e di që është i ndaluar, por tipizon, është tipikja, vetë vigjilencën revolucionare, që nuk tërhiqet as në shi e furtunë.

Por unë kurrë s'do t'ju them se, edhe në variantin e dytë të romanit "Dimri i vetmisë së madhe", që ju e kritikuat, për ta bërë më të partishëm, Enver Hoxha më duket si ata diktatorët e Amerikës Latine, i rrethuar me gardë të armatosur deri në dhëmbë etj., etj. Dhe ajo mbledhja e 81 partive në Moskë, ku Enveri juaj shkëlqen, për mua është masakër komuniste, kështu e lexoj unë, se dua. Internacionale dinozaurësh, përbindëshash...

(nxjerrë nga libri "Rrugët e ferrit")

Kadare dhe Visar Zhiti, 21 maj 2019
Foto: Bujar Hudhri

Një lypës në Paris...

...drita dhe fantazma mrekullish. Një shëtitje pas mesnate… me Kadarenë, që po më pyeste për në Shqipëri. Ndërhynte dhe herë pas here ndalej, kthehej nga unë, unë miratoja, ndërsa s'po kuptoja më gjë, i përpirë nga habia, isha në Paris pranë tij, ja dhe kulla marramendëse e Ejfelit, dilte herë pas here, sikur të mos ishte një, përçonte lart nëpër yllësi vetvetet e saj të shumta si dehje të përndezura…

Na u afrua një lypës, i veshur mirë, po kërkonte me një frëngjishte hokatare ca franga. Dhe Kadareja ia dha po aq gëzueshëm. "Blen një shishe verë me to, - më tha, kur u larguam, - dhe diçka më tepër." S'po kisha të lodhur. Megjithëse gjatë ditës isha endur nëpër pavionet e Luvrit, shtatë orë… nëntë…

- S'rrihet aq shumë, - më qortoi me dashamirësi Kadareja. - Dy-tri orë e shkohet prapë një ditë tjetër.

- S'e di a vij prapë, a shihet dy herë e njëjta ëndërr, - thashë. Por s'po më hiqej nga mendja një shishe verë për lypësin e natës në Paris! Jepi verën që i takon tjetrit, racionin e gëzimit të tij, m'u dëgjua një si britmë. Do t'ia japësh apo…

Përveç ndjenjës së mëshirës, lypësit sikur rikrijojnë diçka nga besimi i dëshpëruar te njeriu, tek ato rastësitë si lidhje me të panjohurën… e domosdoshme. Mbase… sipas meje… Të mendosh dhe për verën e tjetrit. Ky është Parisi… i rrallë, gjenial… i gjithhershëm...

- Ndahemi, - dëgjova zërin e Kadaresë. Po unë do të doja ta përcillja deri te porta e shtëpisë së tij... Po mbaronte edhe kjo natë. Merrja tjetrit sasinë e tepërt të errësirës, jepi racionin e dashurisë, të fjalëve…

(nxjerrë nga libri "Ferri i çarë")

Kalimet e nëndheshme

Tregim nga Kadare

Ç'mendoni lidhur me fjalët e hapura për kalimet e nëndheshme në N.? Sigurisht i keni dëgjuar. Ka një javë që nuk flitet veç për to, apo jo? Mendoni se e gjithë kjo ka ndonjë arsye, domethënë ka lidhje me shkaqe, si të themi, të rrokshme, apo është diçka e pashpjegueshme, si të thuash, misterioze, për të përdorur një fjalë disi jashtë kohe.

Kalimet e nëndheshme? Hm. Sigurisht që kam dëgjuar. S'ka njeri që mund të thotë se s'ka dëgjuar për to. Sa për arsyet, ato më duken më shumë të pashpjegueshme. Shkurt, do të thosha të njëjtën fjalë që përdorët ju, misterioze.

Herë të tjera është folur për to?

Mund të them se po... Nëna ime, për shembull, më ka treguar. Gjyshja gjithashtu, dëgjuar ndoshta nga nëna e vet.

Domethënë, është një pëshpërimë që hapet herë pas here. Në trajtë qerthullore ose ciklike, po të përdornim një fjalë të sotme. Pikërisht për këtë doja edhe të pyesja: a mendoni se pëshpërima nxitet ose kushtëzohet nga shkaqe të njëmendta, si për shembull, dëshira për t'u fshehur në periudha terrori ose në kushtet kur njerëzit krijojnë sekte të fshehta, shoqëri masonike e të tjera gjëra të kësaj natyre?

Hm. S'mund ta them. Herën e fundit, për shembull, kur shpërtheu thashethemja për to, para njëzet vjetësh në mos gaboj, qyteti ynë ishte më i qetë, për të mos thënë më i fjetur se kurrë. Dhe ja, midis amullisë ia dha papritur...

* * *

Gazetari, me gishtat e ngrirë nga të ftohtit, çka i jepte lëvizjes së tyre një lloj mospërfilljeje, shfletonte shënimet e mbledhura gjatë asaj jave të mërzitshme në qytetin e vogël provincial. Një qytetth në ethe. Kështu mendonte ta titullonte shkrimin, ndërsa me vete thoshte: O Zot, edhe në ankthin e tij ai është i mërzitshëm.

Nga dritarja e vetme dukeshin dritëzat e zbehta që regëtinin humbshëm. Ai i la shënimet, për të ndezur një cigare, të cilën e shoi para kohe për të hapur prapë letrat. Ishin aty gjithfarë të dhënash të nxjerra nga muzeu i vogël, nga arkivi i bibliotekës, copa nga gazetat e vjetra, si edhe intervistime njerëzish të moshave e punëve të ndryshme. Nga të gjithë dilte pak a shumë e njëjta gjë: që psikoza për kalimet e nëndheshme as shpjegohej dhe as lidhej me ndonjë rrethanë të dukshme.

Gazetari e kishte ndier se karriera e tij lidhej me këtë shkrim dhe ky shërbim ishte shansi i fundit që po i jepte kryeredaktori, pas një sërë dështimesh. Ideja se ndoshta nuk do t'ia dilte as këtë herë i jepte qysh tani dëshirën të ulërinte.

Nga gjithë të dhënat dilte se në këtë qytet (me zor e mbante veten të shkruante "në këtë qytet të mallkuar"), thashethemja për kalimet e nëndheshme shpërthente herë pas here papritur. Ishte, me sa dukej, një lloj tërmeti i brendshëm te njerëzit, një lloj dëshire për rindërtim, për të ndryshuar në qytet diçka, për të zëvendësuar rrugët e dukshme me të tjera, të mjegullta e të padukshme. Shkurt, për të krijuar një urbanistikë të re, të dyzuar.

Si lindte kjo, ç'e nxiste, ç'e kthente në psikozë të përbashkët, ishte vështirë të shpjegohej.

Ëndërr për një metro? Ai e kishte shkruar dhe nënvizuar disa herë këtë frazë dhe sado që i ngjante e palogjikshme, i vinte keq të ndahej prej saj. Qyteti kishte më pak se njëzet mijë banorë dhe, sado të ngushta e të këqija t'i kishte rrugët, ato ishin në gjendje të përballonin të gjitha lëvizjet e banorëve të tij, qoftë edhe në rastet më të skajshme, si për shembull, në turbullira, ikje në panik nga qendra ose dyndje drejt qendrës, madje edhe më keq, në raste të mundshme të një dehjeje ose lajthitjeje mendore të një pjese të banorëve, pra, në kushte kur mund të përfytyrohej një lëvizje e tyre krejt e çmendur (vrapim me krahë të hapur, ecje mbrapsht si gaforrja, ecje me kokëpo-shtë etj., etj.).

Ideja e metrosë, sado joshëse të dukej, nuk qëndronte. Vetë fakti që kronika e psikozës së kalimeve të nëndheshme në N. ishte më e vjetër se gjithë metrotë e botës, e hidhte poshtë pandehmën.

Ai u ngrit dhe iu afrua dritares. Nga qelqet vinte e ftohta e hidhur e qytetit, me të cilin atij i dukej se nuk mund të kishte veçse një marrëdhënie armiqësore. I mallkuar, shfryu më në fund me vete, s'të mjaftojnë rrugët e shtrembra ku kalimtari mund të thyejë kokën, po, na tani, na shpikke edhe kalimet nën tokë.

Dukesh i qetë, vazhdonte të shfrynte kundër qytetit, po gjithë këto pandehma për zgafellat nuk dëshmonin veç për pasione të nëndheshme, sekte, përbetime. Dhe njerëzit ndaj ecnin si të shushatur në rrugë, ngaqë një pjesë të mendjes e kishin nën tokë.

Prej kohësh kishte rënë nata dhe kërkimet e kalimeve të nëndheshme me siguri kishin filluar. Tani me dhjetëra banorë të N., me sy të çakërritur nga kureshtja dhe lakmia, duke mbajtur në duar fenerë a bishtukë vajguri, zbritnin nëpër qilarë të braktisur, çokitnin muret, gërvishtnin aty-këtu suvanë e tyre, duke kërkuar dyert e fshehta, të maskuara me kujdes, të kalimeve të nëndheshme. S'dinin as vetë ç'kërkonin: florinj të fshehur, kufoma të humburish apo kryqe të dikurshme. Gazetari qe i bindur se pasioni për gjetjen e kalimeve i mbulonte gjithë të tjerat.

Thuhej se një nga kalimet bashkonte shtëpinë e Shtinove me atë të Xhulajve. Kishte zëra që ngulnin këmbë se një hulli e fshehtë zgjatej nën thertoren e qytetit për të dalë në lagjen matanë kështjellës. Të tjerë flitnin për gërmaja që niseshin nga shtëpia e Shametëve dhe e Hankonatëve gjer te kisha e vjetër dhe që andej në Sheshin e Zinxhirëve e ndoshta më larg.

Dy ditë më parë ai kishte bërë një hartë të thjeshtësuar të qytetit, ku kalimet e mundshme nëntokësore i kishte shënuar me vija të kuqe, të ndërprera. Gjatë atij mëngjesi qe përpjekur të bënte një hartë të dytë, përsëri me kalimet e përfytyruara, po këtë herë të dikurshme, domethënë përpara njëzet vjetësh. Duke i krahasuar të dyja hartat (kalimet e vjetra qenë shënuar me vija blu), përpiqej të gjente një lidhje midis të dyjave. Herë-herë i dukej se lidhje kishte, madje mjaft të qartë, po pas pak dyshonte se ai përkim ose largim rrugëtimesh s'ishte veçse një rastësi.

Në shënimet e tij kishte disa të dhëna për shtysën e parë që flitej se paskësh nxitur fillimin e psikozës. Herën e fundit, përpara njëzet vjetësh, dyshohej se zhdukja e një nuseje të Mezinate qe bërë shkas për trazimin. E kishin kërkuar trupin e nuses në sternën e shtëpisë (vendi i parë që i shkonte gjithkujt ndër mend për të kërkuar një nuse të mbytur) dhe, meqenëse pas zbrazjes së sternës nuk qe gjetur asnjë gjurmë e saj, u hapën fjalë se ajo qenkësh arratisur nga shtëpia nëpërmjet një udhe të nëndheshme. Edhe më përpara, në ndezat më të hershme, flitej se disa herë qenë bërë shkas ëndrrat ose vegullitë. Iu bë në ëndërr Shën Kozmai, rrëfenin, dhe i tha se anë atë vend, midis Urës Njëharkshe dhe Sokakut të të Marrëve, ndodhej një ikonë e florinjtë, fshehur aty që nga koha e ndjekjes së parë të të krishterëve. Po të gjitha këto s'ishin fort të besueshme. Për të njëjtën psikozë rrëfenin fillime e shkaqe të ndryshme, madje, në shumicën e rasteve, kaq e fuqishme ishte vetë ndeza, saqë shtysa e parë ngjante e pabesueshme, siç do të dukej e pabesueshme tërheqja e një bualli prej një thnegle.

Sytë e gazetarit nuk i ndaheshin vijës së kuqe të ndërprerë që bashkonte shtëpinë e Hankonatëve me atë të Shametëve. Shumica e të intervistuarve ishin në një mendje se për psikozën e fundit qe bërë shkak pikërisht përçartja e plakës Miriam të Hankonatëve. Në shtratin e vdekjes, pak çaste përpara se të jepte frymën, ajo kishte thënë: "Shkoni të hapni shtegun e nëndheshëm për te Shametët. Hiqeni ujët me kujdes, se ka gropa. E bëtë gati fenerin? E keni derën në të djathtë të lëfytit të sternës. Është mbuluar vetëm me një gisht suva."

E kishin kërkuar vërtet derën fill pas varrimit të saj (gazetari kishte parë me sytë e tij çmërsin e gërryer), po nuk ishte gjetur asnjë gjurmë dere a kalimi.

Gazetari ishte interesuar për plakën Miriam, por nga të dhënat nuk dilte të kishte pasur kurrë ndonjë turbullirë mendore apo trandje të shkaktuara nga ndonjë fatkeqësi. Përkundrazi, kishte famën e njërës prej grave më të bukura e më të lumtura të derës së vjetër të Hankonatëve. Ashtu dhe kishte vdekur, e rrethuar nga fëmijët dhe mbesat e saj, madje dhe sëmundja e tillë i kishte ardhur, e qetë, thua se kishte qenë më shumë lodhje se sëmundje, saqë shumë njerëz, duke e parë ashtu të bukur e luksoze në arkivol, me tejqyrën e vënë mënjanë (o Zot, ç'do të shikojë me to në varr të zi, kishte thënë plaka Shano), shumë njerëz, pra, duke e parë për herë të fundit, kishin psherëtirë: lum ajo!

Mirëpo ja, pa zbritur mirë në varr, në burgjet e shtëpive kishin krisur mihësja e çekiçi. Dhe bashkë me zhurmat e para, njerëzit kishin thënë: ç'qe ajo fjalë që na the duke ikur, moj Miriam?

Gazetari qe ngritur dhe po ecte poshtë e përpjetë nëpër dhomë. Përpara se të thoshte "jo!" me zë, ai e mendoi atë "jo" shumë herë, por e menduar ajo ishte shumë më e fuqishme.

Jo, tha më në fund dhe kërkoi paketën e cigareve. Kjo punë s'mund të ishte kaq e thjeshtë.

Ai, që kur kishte mbërritur natën e parë në N., kishte thënë me vete: o Zot, sa të kalojnë këto dy-tri ditë shërbimi e të iki këndej nga sytë këmbët, as që kujtohej tani për kthimin. Telegrameve të redaksisë nuk u përgjigjej më, madje i hidhte në kosh pa i lexuar. Kaq shumë ishte i përpirë nga hulumtimi që po bënte, saqë ishte i bindur se kur t'ua tregonte të tjerëve do t'ia falnin gjithçka.

Qyteti N. ishte plot arkiva familjare, një pjesë të shkruara me alfabete të fshehta, që zakonisht i kishin gjithë shtëpitë e vjetra. Në to gjendeshin gjithfarë shkresurish, letërkëmbime, dëshmi gjyqësore, kopje testamentesh ose kronika të ngjarjeve kryesore të familjes.

Ai e nisi hulumtimin pikërisht nga arkivat e Hankonatëve e të Shametëve. Për të arritur t'i shfletonte iu desh të vinte aq shumë energji, lajka e premtime sa ç'nuk kishte shpenzuar as për fejesën e vet të parë, atë më të vështirën. Pas kësaj, deshi që gjithë shënimet e nxjerra t'i krahasonte me pëshpërimat që mund të kishin qarkulluar nëpër qytet për këto dy shtëpi. Kjo gjë nuk ishte e vështirë, ngaqë pothuajse gjithë shtëpitë e vjetra të N. kishin pasur me njëra-tjetrën ndonjë histori të gjatë ose të shkurtër. Kështu, ai nuk e pati vështirë që ato dy letra të arkivit të Hankonatëve, ku flitej vagëllimthi për fisin e Shametëve, pandehmë që një syri të jashtëm do t'i kalonte e pavërejtur ose, së paku, do t'i dukej e pavend, pra, ai nuk e pati të vështirë që, prej krahasimit të këtyre dy letrave me një thashetheme të hapur shumë kohë më parë për një krushqi të mundshme midis dy shtëpive, të vinte në përfundimin se një krushqi do të qe shestuar vërtet, por prej saj qe hequr dorë më pas, pas të dhënave të mbledhura prej Hankonatëve për një sëmundje të trashëgueshme në fisin e Shametëve. Po zbulimi i vërtetë i gazetarit ishte një letër tjetër, këtë herë e Shametëve, ku thuhej: "Sa për H., ajo punë u mbyll tani dhe është vërtet mëkat, ngaqë të dy e pëlqenin njëri-tjetrin, e sidomos vajza, sipas të dhënave të sigurta që kemi".

Prej letrës së fundit dilnin të dhëna të reja, e para, që vajza "sidomos" e pëlqente dhëndrin dhe, e dyta, se vajza ishte nga Hankonatët.

Mendimi i parë i gazetarit ishte që këtu s'ishte fjala për krushqi, po për një lidhje dashurie. Ndryshe, si ishte e mundur të pëlqeheshin e "sidomos" ta pëlqente vajza?

Lidhja e dashurisë u përzie aty për aty me ngut, me padurim, në mënyrë të pazgjidhshme, me kalimin e nëndheshëm, nëpërmjet të cilit ata takoheshin. I përfytyroi të dy duke kërkuar njëri-tjetrin nëpër terr, me fener në dorë, duke shkelur nëpër pellgje të zeza, sipër gropave, thellë nën tokë...

Vrapoi prapë te sterna, por atje s'ishte veç muri, me çmërsin e gërryer nga kërkimet, i ftohtë, i fortë, simbol i pengesës së pakapërcyeshme, i ndërprerjes dhe i veçimit.

Dhëndri i mundshëm, një burrë i pashëm me "kalcunja të bukura" (ndriste rruga si flakë kur kalonte, sipas të dhënave), kishte vdekur prej kohësh. Asnjë lidhje s'kishte pasur kurrë midis tij dhe ndonjë gruaje tjetër.

Gazetari kalonte ditë të tëra në mejhane, më tepër për t'u trullosur dhe vetë, sesa për të mësuar ndonjë gjë. Një ditë, me një gjysmë buzëqeshjeje ndiqte një bisedë që lidhej me fjalën "randevu". Ca thoshin se ishte një fjalë e re, po mishtari Hill ngulte këmbë se fjalën e kishte sjellë njëzet vjet më parë një aeroplan. Ju kujtohet kur u hap aeroporti? thoshte ai. Që me aeroplanin e parë zbriti një grua. U hap fjala se ajo "kishte një randevu". Askush s'e dinte në atë kohë atë fjalë, por pastaj u përhap kaq shumë, saqë edhe hamejtë jevgj, kur porosisje qymyrin, pyesnin: kur do ta lëmë randevunë, zotni?

Gazetari u kthye në hotel dhe nga fytyra s'i ndahej nënqeshja e lodhur. Ai u ul mbi shtrat, nxori fletoren dhe shkroi: "Zbulohet enigma e kalimeve të nëndheshme". Ai u mendua për një kohë shumë të gjatë përpara se të shkruante vazhdimin. Ai do të shkruante se një ëndërrim dashurie kishte shkaktuar psikozën e fundit të kalimeve të nëndheshme në N. Ai do të shpjegonte se si plaka Miriam H. në çastin e fundit para vdekjes kishte folur përçart për kalimin e nëndheshëm, të ëndërruar prej saj gjithë jetën e që do ta çonte drejt njeriut të vetëm që kishte dashur në këtë botë. Në të vërtetë, ky kalim, ashtu si shumë gjëra të tjera të kësaj bote, kishte qenë vetëm në mendjen e saj.

Gazetari e mori shumë herë lapsin dhe shumë herë e la përsëri. Më në fund, ai vuri një kryq sipër titullit të shkrimit dhe e mbylli fletoren. Një ndjesi e brendshme i tha se ndoshta ishte më mirë që të nderonte një pakt të vjetër. E futi fletoren në çantë, si për të bindur veten në vendosmërinë e tij. Mendimi se e fshehta e udhës së nëndheshme të së vdekurës do të mbetej e pazbuluar, për habinë e tij, i dha qetësi.

Tiranë, shkurt 1990

Për të harruar një grua

Tregim nga Kadare

Po tani ç'të bëj, thashë me vete, duke vështruar me radhë flegrat e lagura, të mbufatura nga shiu. Pastaj qilimin, derën, prej nga pak kohë më parë ajo kishte dalë, hirnoren e cigareve, me fjalët "Hotel Turizmi" anash.

Një copë herë u vërtita nëpër dhomë, gjersa këmbët më çuan pranë derës. Qëndrova pikërisht te vendi ku ajo më kishte përqafuar ndërsa dilte, me një përqafim që s'ishte as ndarje dhe as premtim për diçka më të mirë. Një përqafim i tillë te dera, pas një pasditeje të stuhishme, përfytyrohej, zakonisht, në sfond të dënesës, të pendimit për fjalët e ashpra dhe me buzë që synojnë drejt njëratjetrës për të falur gjithçka. Por asgjë e tillë s'kishte ndodhur. Unë i kisha mbajtur duart në xhepa, madje i kisha rrasur më thellë dhe, i ngrirë si dru, ndjeva buzët e saj te qafa dhe pastaj te cepi i gojës dhe prekjen e furishme të flokëve. Mundimshëm ndjeva nevojën ta përqafoja, sipas ritualit mijëvjeçar të mbarimit të grindjeve, por një gips mortor, i ikur nga kushedi ç'shtatore, s'më la të lëvizja.

S'isha penduar për asgjë. Isha vetëm i lodhur.

Në hirnore, dhjetëra bishtat e cigareve, të rënë njëri mbi tjetrin, si në një masakër (të sajtë si të vrarët e njërës palë, asaj pale që për t'u njohur mbante një rrip të kuq, dalloheshin vërtet nga shenja e të kuqit të buzëve), jepnin më mirë se çdo gjë atë që kishte ndodhur: furinë, shpjegimin e vështirë, fajësimet e ndërsjella që i kishim bërë njëri-tjetrit, lotët e pafund të saj. Sikur të kishte gjëkund një muze të hidhërimit, do ta kisha çuar atë hirnore.

Isha i lodhur. Gojën e kisha të hidhur. Doja të pushoja me çdo kusht. Me mosbesim vështrova shtratin, velenxën sipër tij dhe nënkresën. Vërtet shpresoja se mund të flija? Më erdhi të qeshja, kaq e pamundur m'u duk kjo.

Shushurima e shiut vinte që jashtë zbutëse. Duhej ta harroja me çdo kusht, ta nxirrja nga vetja ime atë grua. Por, së pari, duhej të nxirrja atë mbrëmje. Ishte gjëja më e ngutshme.

Duhej ta nxirrja atë grua, sepse gëzimet që më jepte ishin përherë më të pakta se mërzia.

E gjeta veten duke lëvizur nëpër ato pjesë të dhomës ku kishim lëvizur dhe ishim zhvendosur të dy gjatë atyre orëve të çmendura. Dhe përsëri hirnorja me bishtat e cigareve më mbajti në vend. E mora, e ktheva në pëllëmbë të dorës atë grusht bishtash, si të kisha përpara syve një gjë të pabesueshme. Të ftohura, të shkrumbuara vende-vende, ishin tani ato që pak më parë kishin qenë më afër se çdo gjë tjetër pranë fjalëve tona, frymëmarrjes së furishme, pendimit, dënesës.

Iu afrova dritares, shtyva flegrën dhe i flaka përjashta, në terr. Kështu hidhet hiri i të vdekurve, kur e lënë me testament, mendova. Duhej ta harroja patjetër atë grua.

Të përdorja gjithë mekanizmin e trurit tim për ta zhvlerësuar. Ta godisja nga pika të ndryshme, në mënyrë që, kur të vinte ora e harrimit, ta kisha të lehtë rrënimin e saj.

Kisha ende një keqardhje të fundit për këtë, por isha i bindur se s'kishte rrugë tjetër. Do të shtrihesha pas pak horizontalisht (e kisha vënë re se në atë qëndrim mendoja gjërat më shkatërruese) dhe do të filloja... Do t'i ndiente vallë buldozerët që larg, në shtratin ku, ashtu si unë, me siguri, nuk flinte?

Dhe, papritur, më shkrepi në kokë një mendim: e sikur ta shkruaja gjithë këtë? E shkruar, ndoshta kjo mbrëmje mund të nxirrej më lehtë nga vetja. Ta trupëzoja për ta vrarë më lehtësisht.

Ashtu do të bëja.

Për çudi, siç më ndodhte përherë në kësi rastesh, mendimi i të shkruarit më dha qetësi. Si avioni që e nxjerr trupin e vet nga zona e stuhisë, ajo ide, më shpejt se ç'e mendoja, më nxori nga gjendja delirante në një shtresë më të qetë, sipër furtunës.

Dhe më parë se ç'e prisja, fjeta.

E njoha Polin e Jugut që larg (dallohej shtypja, ashtu siç e kisha mësuar në gjeografinë e tetëvjeçares). Dëgjohej një goditje e mbytur veglash. Kur iu afrova edhe më, pashë se atë zhurmë e shkaktonin tre njerëz me shtat të shkurtër. Diçka po bënin me boshtin e tokës. Nuk u bezdisën aspak nga prania ime dhe vazhduan punën e tyre. Dukej si një riparim.

Nuk e di nëse i pyeta ç'bënin ashtu apo vetvetiu m'u bë e qartë: po bënin një ndreqje në bosht. Një ndryshim, me sa dukej, në shpejtësinë e rrotullimit. Prej kësaj do të sajoheshin ditë të ndryshme, jo njëzetekatërorëshe, si më parë, por tridhjetetetorëshe. Kurse netët do të ishin njëzetedyorëshe. Sipas studimeve dhe pyetësorëve të ndryshëm, paskësh qenë më mirë kështu. Kisha përshtypjen se diku kisha lexuar në shtyp për këtë gjë.

Desha t'i pyes: e kur do të fillonte ky kalendar i ri, por, s'di se pse, i pyeta për tjetër gjë: meqenëse merreshin me gjëra të tilla, me siguri, mund të zbërthenin nga bota copa të kohës.

Posi, u përgjigjën ata. Pra, e bënin edhe këtë dhe ndihej që s'e kishin të vështirë.

O Zot, sa e thjeshtë paskësh qenë ajo që dukej e pamundur: të shkulja nga vetja gjithë atë hidhërim.

U mundova t'ua shpjegoja, doja të hiqja nga vetja ime një ditë ose, më saktë, një mbrëmje të hidhur.

Ata qeshën.

Një mbrëmje? Po ne punojmë me copa të mëdha. Gjysma shekujsh, dekada, shumë-shumë, me vite. Kurse ditët janë vocërrima. Megjithatë (vështruan veglat e tyre), ndoshta me ato më të imëtat mund të kapim edhe ditët.

- Ku është ajo ditë? - pyeti njëri prej tyre.

- Si? - ia bëra unë.

- Dita që doni të shkëputni, në ju kuptova drejt. Ju doni ta hiqni atë dhe të lidhni prapë fijet, apo jo?

- Pikërisht.

- Atëherë, ku është ajo?

O Perëndi, s'më kujtohej asgjë. U mbyta në djersë, por koka sa vinte më bëhej më e turbullt.

- Në mos viti, së paku, koha, - tha ai.

Por mua s'më kujtohej asgjë. Dija vetëm që ishte e hidhur, tepër e hidhur.

- Po çka ndodhi atë ditë? Ndoshta, kjo ju kujtohet, - tha ai. - Ç'perandori është përmbysur, ç'tërmet ka rënë?

Vështruan njëri-tjetrin, kur e panë që s'përgjigjesha. Pastaj sytë e tyre të lodhur u kthyen diku anash, atje ku në një shtjellë të largët vërtiteshin, me sa dukej, ngadalshëm perandoritë e rrëzuara, themelitë e tërmeteve dhe skelete shekujsh. Vërtiteshin zymtas, të përshkuar nga vetëtima të ftohta.

Asgjë s'më kujtohej. Vetëm shija e hidhërimit, e pazbutshme, e patretshme.

Pastaj m'u duk se pashë diçka, një si trajtë fustani që e merrte era në një luhatje mortore.

- Një grua, - thashë. - Ishte aty, në atë ditë, një grua...

Ata qeshën, por ftohtë. Pastaj vështruan prapë veglat e tyre.

- Po të jetë ashtu, është e pamundur. Këto vegla s'bëjnë për atë gjë.

- Ma hiqni atë mbrëmje me atë grua, - ulërita.

U zgjova.

Zhurmërimi i shiut më kujtoi më parë se çdo gjë tjetër se ku ndodhesha.

Hotel. Dhe jashtë gjethnaja e rënë dhe kufomat e cigareve të masakruara, ku njëra palë mund të dallohej prej tjetrës nga rripi i kuq...

Ajo ishte aty pranë, disa hapa larg dhe, me siguri, ishte e paqetë dhe kishte makth, ngaqë, në një mënyrë ose në një tjetër, duhej të ndiente që unë përpiqesha ta varrosja.

1981

Në redaksinë e gazetës "Drita" më çoi një student korçar Klito Fundua. Ishte i kundërti im. Futej në zyra si i barabartë, unë me drojë e si me zor.

Mund të ketë qenë vjeshta e vitit 1964. Dera e redaksisë së "Dritës" ishte e hapur. Kadareja, në këmbë po fliste me dikë tjetër.

Një tip jo shumë i afrueshëm, por as i ftohtë. Trup i brishtë, por i lidhur dhe me elasticitet . Portreti i hajthëm. Nën syzet një vështrim qetësisht i mprehtë. Buzët të plota, hunda e vogël pak e kthyer lart. As i rëndë, as zyrtar, por jo dhe nga ata me të cilët mund të merreshe vesh lehtë.

Jam student, i thashë

Ke sjellë vjersha, lëri aty.... Dhe më tregoi tryezën.

Pas një kohe, për herë të parë poezinë time e pashë të botuar në gazetë. Janar 1965.

Ai me shtat të brishtë, por atletik, që kur ngrihej më këmbë, mbështetur pas tryezës, herë-herë pëllëmbën e dorës së majtë e rraste nën rripin e pantallonave, ai redaktori i poezisë në gazetën më të rëndësishme letrare të shtetit, të kryeqytetit shqiptar, paskej qenë njeriu me të cilin mund të mbaroje punë pa u ulur në kafe, pa ndonjë pije a drekë.

Kështu e njoha.

Dhe gjithmonë kështu kam dashur ta kem në jetën time atë njeri.

Në një distancë të respektuar.

Mbi të gjitha Kadarenë e respektoja si shkrimtar, shkrimtari që nuk kishte pranë shok tjetër në këto mjediset tona.

E ruajta këtë distancim ndaj tij edhe kur u bëmë të afërt. Gjithmonë për mua Kadareja ishte shkrimtari. Njeriu që bënte letërsinë më mirë nga shumica e shkrimtarëve të kohës, shkrimtarë që i njihja a nuk i njihja, vendas a të huaj, shkrimtarë që ishin a nuk ishin përreth tij.

Ishte mrekulli të ndodheshe në të njëjtën kohë, nëm të njëjtin ajër ku frymonte ai.

Tani vonë, para disa vitesh në shtëpinë e tij aty në Skay Tower e shihja të ulur në tavolinën e sallonit veshur me një rrobe shtëpie të gjatë deri nën gjunjë. Po shkruante faqet e fundit të romanit Darka e gabuar. Më preku e njëjta ndjesi admirimi si ajo e shumë viteve më parë. Mendoja: kam qenë me fat që u ndodha pranë me këtë njeri.

Ky që po shkruante faqet e fundit të romanit Darka e gabuar, tashmë një burrë në moshë, mbetej ende i paepur në përkushtimin, në përgjegjësinë ndaj profesionit të tij.

E prita sa përfundoi një paragraf të romanit. Me letrën përpara, me stilolapsin në dorë e shihja dhe e adhuroja në heshtje. Mjeshtër i jashtëzakonshëm i letërsisë me penën në dorë, si ushtari mban shpatën e shenjtë në duart, shpatë që dorëzohet me fundin e veprës o me jetën e tij.

Këtë admirim, si përherë, e mbaja brenda vetes. Dhe kur uleshim më pas në një drekë në shtëpinë e tij, kur pinim një kafe, ose kur dilnim në shëtitje nëpër kryeqytet. Kurdoherë flisnim si dy njerëz të afërt, si dy miq.

Nuk e përfola kurrë, nuk ia thashë atij a të tjerëve admirimin tim.

Le të kthehemi pas, te vitet 1960, kur e njoha.

Ai hyri në letërsinë shqipe si emancipuesi më i madh i saj. Kur ishim të rinj, lexonim poezitë e tij për dashurinë. Ne dhe shoqet tona ato lexonim të parat. Vinim re se në vargjet e tij mund të dashuroheshe dhe të ndaheshe normalisht. Pa dramën e ndarjes shkatërruese si tek ne. Ai shkruante se në muajt e verës dashuroheshin miliona, ndaheshin miliona. Dashuria në poezinë e tij ishte çështje stine. Në Shqipëri një vajzë, sado ta doje, të torturonte. nuk lidheshe dot intimisht me të as për një vit.

Ishte emancipues i artit tonë. Në prozë e në poezi. Idetë e mëdha, teknikat e freskëta ishin risitë që hynë bashkë me artin e tij. Deri tek ai, romani shqiptar ishte në shpërgënj. Me një roman si "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" ai përnjëherë e çoi stekën aq lart sa kur u botua në Francë, menjëherë Gjenerali.. u quajt roman botëror.

Kadareja atëherë nuk ishte as tridhjetëvjeçar.

Dhe ky njeriu me trup hollushi nuk ishte aq qibar në sjellje me ne të panjohurit, me ne të rinjtë. Në mënyrën e tij na donte. Të gjithë ata që kanë shkruar poezi në

Admirimin për Kadarenë, si përherë, e kam mbajtur brenda vetes

Nga Sadik Bejko

vitet 60-70 kanë shkuar nga duart e tij. I merrte poezitë, i lexonte në syrin tënd dhe të thoshte kjo botohet, kjo nuk botohet. Dhe ai e mbante fjalën, në numrin e ardhshëm të gazetës e shihje të botuar poezinë që ai ta kish pëlqyer.

Me Kadarenë, nëse kishe shans, mund të bëje dhe një shëtitje në këmbë deri në sheshin e kryeqytetit. Rrugës Kadareja të jepte përshtypjet e tij për poezitë që kishte lexuar prej teje, edhe për ato që nuk ishin botuar.

Mbaj mend që ai ishte për një poezi jo të errët dhe jo për figuracionin e ngarkuar.

Të fliste si miku mikut, por logjika, siguria në ato që thoshte, i jepte atij peshën e një njeriu autoritar, të një person shumë më të moshuar nga ç' ishte.

Ishte shtatë a tetë vjeç më i madh nga ne.

Poezinë e tij e dinim përmendësh. Dhe për një fakt që sot mund të duket i tepërt. Në vargjet e tij kishte kryeqytete të ndritshme, kafe luksoze, aeroporte, magnetofonë, tv, taksi, konjak… një modernitet shumë joshës për një vend që edhe në kryeqytetin e tij ende transportohej me gomerë, me karroca, me pajtonë tërhequr nga kuajt, me qerre të tërhequra nga buajt.

Atëherë mes njerëzve tanë, zyrave tona, mbizotëronte lloji i marrëdhënieve folkloriko-orientale. Një lidhje e tillë mbeti deri vonë dhe mes njerëzve të kulturës. Që të mbaroje një punë, duhet më parë të shkoje në një darkë a drekë me pije e me shumë tym duhani, me kafe që nuk mbaronin kurrë.

Kadareja kishte një tjetër çelës për t'u lidhur me njerëzit. Intuitive, të shkurtër, të drejtpërdrejtë. Të mbështetur te vlerat profesionale dhe etike. Pa ndonjë interes. Kadareja kujt mund t'i bënte të mirë, pa pritur kurrë ndonjëtë tillë nga ata që u vinin rretherrotull redaksive si insektet a si bletët.

Kjo sjellje ishte pak si shumë qytetare për në vend ku bagëtitë shëtisnin ende mes qytetit.

Kisha botuar disa poezi në "Drita". Bashkë me Pandeli Koçin, Ilo Spassen dhe Ahmet Golemin e ftojmë Kadarenë në një takim me studentët. E pritëm me një tufë lule mimozash që ne i kishim këputur nga degët e pemëve. Ishim me pardesy, pra do ketë qenë dimri i vitit 1965-66. Kadareja i shpërfilli mimozat tona, pa na e bërë shumë të madhe. I vumë në një cep trzyeze. Foli siç dinte ai në bisedën me studentët. Mbaj mend se foli me vlerësim dhe me mëshirë për një shkrimtar të ri, për Bilal Xhaferin. Tha se është me talent, por fatkeq. Ç'domethënë fatkeq? Atëherë nuk flitej me këtë gjuhë në ligjërimin publik. Shprehja politikisht korrekte duhet tëishte: ai është me biografi politike të keqe.

E ftuam në një mbrëmje vallëzimi. Bashkë me të erdhi dhe regjisori Piro Mani. Shoqet tona studente ishim vajza të bukura. Artistët ato i pëlqenin.

Berat viti 1966-67.

Do të veçoj dy tre momente.

Mbas shkollimit, isha emëruar drejtor i shkollës tetëvjeçare në Syzes.

Kadareja në Berat erdhi si korrespodent, si i dërguar i gazetës Drita në bazë. Ishte njëlloj të dërguari me hile. Me të futur. Në ato vit kishte shpërthyer një ngricë politike komuniste, ngricë nga ato që herë pas here kapnin jetën e vendit dhe të ngjethnin mishtë. Kryheshin veprime mizore dhe quheshin revolucionare. Pa asnjë faj të shpallur, shkrimtarët më të mirë të kohës me vendim partie, i kishin degdisur larg familjes nëpër rrethe. Që të njihnin jetën. Në fakt ishte një ndëshkim i pashembullt, një poshtërim kolektiv dhe publik i shkrimtarëve shqiptarë. Thellë-thellë kërkohej që ata të bënin një letërsi servile ndaj shtetit.

Kadareja banonte në një dhomë me aneks. Bënte reportazhe për gazetën. E vlerësonin në kreun e rrethit. I kërkova që të më lironin nga drejtor shkolle.

Pas një jave, kur kthehesha nga fshati Syzes, më thotë se nuk i kishte ecur me porosinë time. E kishin pyetur pse ndërhyn që të shkarkojmë një drejtor shkolle, mos nuk është i aftë? Kadareja ishte përgjijur se miku im është shumë i aftë, por ai do që të bëjë letërsi dhe kjo kërkon kohë. Ashtu? i thanë, nëse është i aftë, të mësojë vështirësitë. Revolucioni i do njerëzit e aftë.

Duhet të kisha thënë që je i pazoti, më tha Kadareja i zhgënjyer. Po nuk mund ta thoja.

Në kafe. Çfarë ke shkruar më pyeti? Një poezi për një bari që shkon në luftë, vdes dhe kthehet të ruajë prapë bagëtitë e tij.

Kjo është tema ime, më tha , ti ma ke marrë.

U habita. Nuk më kishte lexuar një gjë të tillë.

Unë e botova në"Drita" poezinë"Kënga e xha Canes". Një javë më pas Kadareja botoi poezinë e famëshme "Kënga e ushtarëve të vjetër"… "nga lufta vijmë në luftra shkojmë/ dhe tjetër fat s'kërkojmë ne".

Në një intervistë tëatyre ditëveKadareja thoshte se kishte lexuar poezinë"Kënga xha Canes", të S. Bejkos,poezi e cila i kishte pëlqyer shumë.

Jemi buzë lumit Osum. Një vesë shi mbi kokat tona. Kadareja i zymtë. Kërkon mendimin tim për romanin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur". E kisha rilexuar romanin edhe për një shkak:kritika e lartë, profesorët, akademikët e kohës e sulmonin keq romanin. Një fushatë e trishtuar. Dukej si sulm i orkestruar politikisht. Në fakt kritika, kultura, Shqipëria e kohës nuk ishin të përgatitura për ta përtypur një ushqim aq të lartë letrar si ai që po ua shërbente pena e Ismail Kadaresë.

Ishte një moment hutimi, kur njeriu kërkon një referencë.

Gjithmonë e adhuroja në heshtje, brenda meje. Ruhesha që dhe ai mos ta dinte. Askush tjetër. Është një lloj i sjelljes shqiptare. Burrat nuk ia hapim barkun tjetrit.

Atë mbrëmje nën shi unë i fola në vesh Kadaresë fjalë shumë të mira për Gjeneralin… Por jo si një fans i tij. Si vlerësues i ftohtë. Kur mbarova, shumë serioz e pyeta. Tani që e di mendimin tim, më thuaj, ç'mendim ke ti për romanin tënd?

Ai foli dhe unë "u pataksa", siç thuhet te De Rada.

Kadareja foli pa modesti. Më tha: Është një roman me temën e ushtarit, temë e rrahur ndërkombëtarisht nga Hemingueji dhe Remarku. Dhe Gjenerali im, po të përkthehet, do të përsëritë fatin e romaneve, si: "Asgjë e re nga fronti i perëndimit", apo "Lamtumirë armë".

Këtë radhë isha unë që mbeta pa fjalë. Sado adhurues i tij, nuk kisha shkuar aq larg sa ta krahasoja romanin e tij me ata që tha ai.

Por koha atij i dha të drejtë, jo mua. Gjenerali u përkthye me sukses në 40 gjuhë botërore. Atëherë dhe një adhurues i thekur si unë, këtë nuk e priste, as nuk e mendonte.

Një mbrëmje me shi buzë lumit Osum më 1966, në Berat.

Festime për 25 vjetorin e themelimit të Partisë. 22 tetor 1966 në Berat. Kadareja ca ditë më parë në gazetën Zëri i Popullit kishte botuar poemën shumë të diskutuar, "Shqiponjat fluturojnë lart".

Në ato kohë në rrethet letrare të kryeqytetit diskutohej se ka shkrimtarë që ia kanë me zemër Partisë, ka dhe disa të tjerë që për interesa, për karrierë, i janë qepur asaj mbi kurriz. Pa dyshim Kadareja hynte te ata që Partisë ia kanë me interes. I dëgjoja kur fshehtas këta vërrisnin kundër Kadaresë: ai intelektuali, ai krrieristi, i pabesi i Partisë. Le të bënte poezi për Partinë, le të na vërtetonte të kundërtën. Ai është pa zemër. Dhe sipas tyre ata pa zemër,nuk mund të bënin art të madh për Partinë.

Kadareja me botimin e poemës "Shqiponjat…" e hidhte poshtë këtë profeci.

Ishte në rrugë me autoritetet e vendit.Po shkonin në një pritje për nder të festave. Më pa nga larg, dhe erdhi me të shpejtë.Nuk e zgjati. Si t'u duk poema, me tha. Midis nesh nuk kishte ceremoni.

Më pëlqeu shumë, i thashë. Hodhi poshtë dhe profecitë e liga se ti nuk je me zemër për këtë festë ku po merr pjesë.

Më vështroi sikur të isha në largësi për të matur a ishte i vërtetë vlerësimi im. Ia thashë prapë: urime.

Atëherë, si gjthmonë ai kishte gjetur rastin të më befasonte me përgjigjen e tij. Asnjëherë nuk gabonte. E dinte kush ishte, dhe ku e kishte vendin arti i tij.

Më tha: faleminderit. Por do ta vuaj këtë poemë. Unë e di se çdo të heq. Poema do të recitohet aq shumë deri në bezdi, satë dalë një tjetër më e mirë.

E dha përgjigjen sikur ta kishte gati. Dhe iku u përfshi në rreshtat e atyre që po festonin.

Prapë unë kisha mbetur shtang nga fjalët e tij.

REFUZIMI PËR TA RIPRODHUAR STRUKTURËN AUTORITARE NË LETËRSI

Nga Ali Aliu

Përmes krijimtarisë monumentale të Ismail Kadaresë, letërsia shqipe për herë të parë preku majat letrare evropiane dhe botërore dhe arriti të shpërthejë jo vetëm izolimin ideologjik por edhe kufijtë stilistik dhe shterpësinë letrare të realizmit socialist. Në një mjedis që përpiqej të shpërfytyrojë letërsinë përmes veprave të porositura në shërbim të interesave ditore të politikës, Kadare arrin të dëshmojë epërsinë e artit, në radhë të parë duke e shpëtuar gjuhën dhe mendimin e lirë nga zvetënimi orvelian.

Si çdo lloj tjetër diskursi, letërsia është riprodhim i strukturave ideore të shoqërisë që e prodhon dhe njëkohësisht e konsumon atë letërsi. Kadare arrin ta shkatërrojë ciklin vicioz ideologjik përmes rrëfimtarit joautoritar dhe mosndërhyrës duke e nxitur bashkëndiesinë e lexuesit dhe duke e inkurajuar interpretimin e lirshëm, kritik, e të pavarur nga tutela e autorit didaktik e moralizues.

Edhe në prozën e tij më të re pas largimit nga Shqipëria, Kadare vazhdon t'i përsosë tiparet kryesore të krijimtarisë së tij: përgjegjësinë artistike-letrare, kombëtare, dhe atë politike. Fakti që Kadare tani i artikulon drejtpërsëdrejti mesazhet politike, nuk e ka dobësuar përgjegjësinë e tij politike në letërsi. Dhe ajo që është më e rëndësishme, këto mesazhe nuk bëhen në formë predikimi, siç ndodh jo rrallë në letërsinë shqipe, por transmetohen përmes gjetjeve të reja të shprehjes letrare. Pikërisht kjo mjeshtëri e rrëfimit e bëri të vlerësuar Kadarenë ndërkombëtarisht, jashtë klishesë tipike të interesimit të Perëndimit për disidentët. Vetë autori në një intervistë dhënë BBC-së (11 qershor 2005) shpreh pakënaqësi me etiketimin e veprës së tij si 'politike': "Kur unë them që nuk jam një shkrimtar politik e them këtë me bindje, sepse duke e njohur mire letërsinë e madhe botërore, e di qe doza e politikës është një gjë e pashmangshme në letërsi, është pjesë e jetës dhe shkrimtari nuk duhet te ketë turp nga politika, por që të pasqyrosh ne veprën tende edhe rrethana politike ku jeton, kjo s'do te thotë aspak që ti je një shkrimtar politik. Termi me duket është i gabuar."

Në veprën e Kadaresë identiteti kombëtar paraqitet si sfidë dhe kërcënim ndaj sistemit diktatoriali, ai flet

për identitetin e lashtë të Shqipërisë, për Shqipërinë më të lashtë dhe më të përjetshme se ajo e Enver Hoxhës. Është interesante të vërehen tendencat e reja në Shqipëri dhe në Kosovë, që e shohin etnicitetin si romantizëm politik dhe si relikt anakronik, e që më shumë i gjasojnë kozmopolitizmit të dikurshëm marksist. Prandaj ky dimension i përgjegjësisë kombëtare të veprës së Kadaresë ngel ende tejet aktual.

Universi letrar i Kadaresë është shënjues i një epoke letrare shqiptare, duke integruar fragmente të shpërndara në kohën dhe hapësirën shpirtërore – letrare shqiptare, duke u përplotësuar hap pas hapi, nga vepra në vepër, duke rrezatuar nga thellësitë mitike, nga bota e përtejme, madje dhe nga zona e errët e ëndrrave. Dimensioni kombëtar i veprës së tij nuk duhet ngatërruar me trajtimin e temave të natyrës unike kombëtare, sepse Kadare ka arritur gjithmonë të përçojë mesazhe universale me krijimtarinë e tij, duke mos rënë asnjëherë në grackat e trajtimit stereotip e ekzotik të kulturës vendase. Kadare hyn në dialog sfidues për egzistencën, me fate e fatalitete, me dramën e përhershme të njerëzimit, dhe pavarësisht izolimit të popullit tonë gjatë shekujve, në krijimtarinë e tij asnjëherë nuk ka pasur urrejtje dhe nënçmim ndaj të tjerëve, që është argument i fortë se mund të ndërtojmë një komb të shëndoshë të bazuar mbi vlerat e civilizimit evropian dhe mbi kauzën tonë të drejtë kombëtare e njerëzore. Është i veçantë kontributi intelektual i Kadaresë për njohjen e drejtë dhe të saktë të çështjes së Kosovës, përmes ndikimit në diplomacinë evropiane dhe shtypin evropian, gjë që ka ndikuar në krijimin e opinionit publik ndërkombëtar. Një angazhim intensiv publik i përmasave të këtilla vështirë se mund të krahasohet me shembull të ngjashëm të ndonjë personaliteti të madh të hapësirave shqiptare, nga cilado fushë e dijes.

Në mjedisin shqiptar nuk kanë munguar sulmet që i janë bërë personalitetit të shkrimtarit të vetëm shqiptar me renome përmasash globale. Meqë ky shkrim nuk ka për qëllim trajtimin e këtyre sulmeve, po e theksojmë se mendimi sipas të cilit përshtatja e pashmangshme dhe e domosdoshme e shkrimtarit brenda regjimit totalitar ka qenë vepër kriminale dhe duhet ndëshkuar, është logjikë tipike diktatoriale, e cila është e verbër ndaj faktit se Kadare ka krijuar art universal edhe brenda regjimit më të egër komunist.

Frymëzimin intelektual dhe shpirtëror që vjen nga letërsia e madhe e ka artikuluar fuqishëm Azem Shkreli në poezinë e tij antologjike "Përshendetje me miq" kushtuar Kadaresë, me fragmente nga e cila dëshirojmë ta mbyllim këtë shkrim. Vetëm shkrimtarët e mëdhenj janë në gjendje të thurrin me kaq çiltërsi odë miqësie për shkrimtarë të tjerë, dhe të pranojnë se për të arritur majat duhet të kesh një model dhe një inspirim. Në vargjet e kësaj poezie, në çaste të thella dëshpërimi, poeti i fton në vetminë e vet miqtë, të përhyjnuarit, qiellorët, që fluturojnë si engjëj në kullën e tij, dhe ia përzënë hijet e terrin, ia ndriçojnë shpirtin, ia mëkojnë besimin, ia largojnë zjarrminë, ia fashitin dhimbjet:

"*Plot fjala është me ju, plot kupa, plot gjiri i nënës*
Kudo e ngado është juaja pos mohit, pos orës së prapë
Dhe krismës prapa shpinës"

KRISTAL

Ka kohë që s'shihemi dhe ndiej
Si të harroj un' dalngadalë,
Si vdes tek unë kujtimi yt
Si vdesin flokët dhe gjithçka.

Tani kërkoj unë posht'e lart
Një vend ku ty të të lëshoj.
Një strofë a notë, a një brilant
Ku të të lë, të puth, të shkoj.

Në s'të pranoftë asnjë varr,
Asnjë mermer a morg-kristal,
Mos duhet vall' prap' të të mbart
Gjysmë të vdekur, gjysmë të gjallë?

Në s'gjetsha hon ku të të hedh,
Të gjej një fushë a një lulnajë,
Ku butësisht porsi polen
Gjithkund, gjithkund të të shpërndaj.

Të të mashtroj ndoshta kështu
Dhe të të puth e t'ik pa kthim.
Dhe nuk do dimë as ne, askush
Harrim ish ky a s'ish harrim.

1979

NË PARKUN QË E MBULUAN FLETËT

Në parkun q'e mbuluan fletët
Të dy ne ecnim qetësisht,
Pas shijes saj ka shtruar vjeshta
Qilim të verdhë, natyrisht.

Ndoshta me mijëra vjet më parë
Mbi këtë vend, ku ne kalojmë,
Të tmerrshëm rendnin dinozaurët
Edhe përbindësha gjithfarsoj.

Nën ta, e zhveshur, dridhej toka,
Megjithatë, për kohë më tutje,
Në thellësira projektonte
Lule dhe qenie më të buta.

Dhe ndoshta si një ëndërr e zbehtë
Iu fanit një muzg i von,
Ky park q'e kanë mbuluar fletët,
Ku, pas kaq shekujsh, ti po shkon.

Nga vagabondët me cigare
Ti mos u tremb, e dashur, kot.
Imazhin tënd as dinozaurët
Shekuj më parë s'e shtypën dot.

Që ti të vije kaq e bukur,
Me këta flokë, me këtë hap,
Toka të egrën klimë zbuti
Dhe akullnajat ktheu mbrapsht.

Dhe s'kish se si të ndodhte ndryshe,
Të ndodhte ndryshe s'kish se si.
U desh të zhdukeshin përbindëshat,
Që te kjo botë të vije ti.

1964

Dyndje kujtimesh

Nga Maria Roces Gonzales

Mbushen, pikërisht tani, 40 vjet që kur Ismail Kadare, shkrimtari dhe *Principe de Asturias* (rajoni i Spanjës nga i cili jam dhe ku jetoj), hyri në jetën e Ramón Sánchez Lizarralde dhe timen, për mos të u larguar më. Ishte në Tiranë: *A pret miq, o i zoti i shtëpisë?*, kur lexuam, të mahnitur dhe thellësisht të prekur, romanin tonë te parë kolosal në shqip: *Dimri i madh (botimi i dytë, i ripunuar i romanit* Dimri i vetmisë së madhe). Atëherë Ramoni filloi të mendonte për t'u ofruar spanjishtfolësve disa nga veprat e tij, drejtpërdrejt nga shqipja, pasi më parë, në vitet 70, ishin botuar *Le général de l'armée morte* dhe *Les tambours de la pluie* të përkthyera nga frëngjishtja.

Më pas dyzet e pesë vepra të Kadaresë, nga romanet dhe novelat, tek poemat dhe esete, të përkthyera në rastin tim, pesë prej tyre në bashkëpunim me Lizarralden dhe tri të fundit vetëm, dhe mund të thuhet se qëllimi fillestar është përmbushur kënaqshem dhe se rezultati, po kështu, thuajse arrin VEPRËN E ONUFRI-T. Kjo dëshmohet në një prej mureve të dhomës time të gjumit, e mbushur me origjinalet nga Fayard dhe Onufri dhe me botimet e ndryshme dhe të shumta në Spanjë, me kapak të fortë, me kapak të butë apo në version xhepi të shkrimtarit dhe *Princi i Asturias*, Ismail Kadare.

Për njeriun, qytetarin, personazhin Kadare kam kujtime të mjegullta të periudhës time shqiptare (1980-1984), periudhë veçanërisht problematike dhe e vështire për të: i trazuar në një darkë të shtëpisë botuese, duke biseduar me dikë në Hotel Dajti, në Durrës me Bashkim Shehun, i habitur kur pata guximin ta prezantoja me një udhëtar insistues spanjoll ... dhe e shoh veten time, mbi të gjitha, duke mbrojtur pa kushte *Natën me hënë*. Për aktivitetin letrar të Kadaresë në Madrid nuk e di më, në këtë pikë, nëse ruaj kujtimet e mia apo i kam marrë hua nga Ramón, por ngjyrat vijnë e theksohen: ja ku është, për shembull në Círculo de Bellas Artes, i rrethuar plotësisht, duke iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me letrat e tij. Në kthimin në Tiranë: *A pret miq, o i zoti shtëpisë?*, tre momente: Prill 2009, me Ramonin (udhëtimi i tij i fundit), Anila Bitrin dhe Remzi Lanin, në shtëpinë e Kadaresë, ku ngrohtësia e Helenës shkëlqen me dritën e vet. Dhe, duke imituar titullin *Mëngjeset në Kafe Rostand*, *Pasditet në kafen e Liqenit* me Ismail Kadarenë e mbushur me zgjuarsi, pasion dhe bujari, i ndaj me Bujar Hudhrin dhe, në takimin e parë, edhe me Anilën dhe Remziun.

Ndaj absolutisht atë që Ramón S. Lizarralde tha në 1998 dhe e përsëriti në tetor 2009 kur Kadare mori Çmimin Princi i Asturias, duke riprodhuar udhëtimin kadarean të të dyve: *«Ajo që filloi si një imperativ me karakter etik: të kontribuoja këtu për të përgënjeshtruar imazhin e deformuar që ekzistonte për atë çka po ndodhte atje, përveç një lloj përmbyllje të një rrugëtimi jetësore të bëja të njohur atë që unë, dhe jo të tjerët, kisha pasur mundësinë të përjetoja personalisht, u shndërrua me kalimin e kohës në një përvojë intelektuale dhe emocionale të një lloji tjetër: duke ndjekur Kadarenë unë përshkova të njëjtën udhë si Bajroni i çalë nëpër shtigjet midis Tepelenës, Gjirokastrës dhe Janinës; kam shoqëruar korrierët e kokave nëpër rrugët që lidhnin Stambollin me Ballkanin; kam kaluar natën në Bujtinën shqetësuese të Dy Robertëve dhe kam pritur vdekjen e pashmangshme në një kullë ngujimi të alpeve shqiptare. Kam vizituar tunelet e tmerrshme të Pallatit të Ëndrrave dhe kam ndjekur në lundrimin e tyre të ethshëm nëpër viset e ashpra të Shqipërisë gjeneralët dhe priftërinjtë që ngrinin të vdekurit nga amshimi i lagësht i varreve të tyre; kam ndarë vetminë e netëve me patriotë të marrë, ushtarë të çartur dhe rapsodë të një kohe tjetër që recitojnë litaninë e tyre dramatike ndërkohë që kundrojnë me mosperfillje fytyrën e gurtë e të pandryshueshme të maleve. Kam pasur mundesinë të zbres në skëterra të tjera që nuk i njihja dhe të udhetoj hipur mbi kuaj të drejtuar nga të vdekur...».*

I dashur Ismail Kadare: Jetë të gjatë, u bëfsh 100 vjec dhe marrsh nga ditët tona!

Përktheu në shqip: Kristina Lani Bitri

Vendi i veprës kadareane në letërsinë bashkëkohore. Disa hipoteza për një vështrim tipologjik mbi *Ismailandin*

Nga Matteo Mandalà

Ditëlindja e Ismail Kadaresë është rasti festiv më i përshtatshëm për të hedhur hipoteza të reja mbi rolin dhe vlerat që gëzon në kuadrin e letërsisë bashkëkohore vepra e shkrimtarit tonë të dashur dhe që patjetër do të jenë në qendrën e vëmendjes në debatin e ardhshëm kritik. Në fakt nga çasti i zbarkimit në Shqipëri të një Çiçikovi me uniformë ushtarake, shtigje të reja do të hapeshin para letërsisë shqipe bashkëkohore. Romani i gjeneralit italian që kërkonte ushtrinë e vdekur në trojet shqiptare, vërtet tërhoqi vëmendjen për talentin e veçantë artistik të autorit të ri, por asokohe askujt nuk ia merrte mendja se letërsia shqiptare nga ai çast e tutje do të ndahej në dy periudha *ante* dhe *post quem*, të lidhura me figurën dhe veprën e Ismail Kadaresë. Në fakt botimi i parë i *Gjeneralit* shënon një kthesë historike që na lejon, nga njëra anë, të pohojmë se *pas* atij botimi asgjë nuk do të ishte më si *më parë*, e nga ana tjetër, t'ia hyjmë një shqyrtimi të plotë të procesit artistik kadarean. Sot ky shqyrtim shkencor është bërë i domosdoshëm pas vendimit të autorit për ta mbyllur përfundimisht veprimtarinë e tij krijuese, duke na detyruar të shtrojmë pyetjen kryesore: ç'vend zë vepra e Kadaresë në letërsinë bashkëkohore jashtë kontekstit letrar shqiptar?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje kërkon një analizë të veçantë të veprës letrare të Kadaresë, qoftë të asaj në vargje, qoftë edhe të asaj në prozë. Një analizë që për shkak të kompleksitetit të temës nuk mund të zhvillohet në mënyrë të plotë dhe shteruese brenda hapësirës së kufizuar të kësaj bisede. Prandaj në vijim do të rrekem të përshkoj pikat kyçe të hipotezës hermeneutike falë së cilës u përpoqa të gjeja fillin e zhvillimit të mendimit estetik të Kadaresë me synim të përshkruaja ato tipare që na lejojnë të vendosim veprën e tij brenda hullisë së letërsisë "moderniste". Për t'ia arritur këtij synimi duhet, së pari, të shmangim çdo lloj qasjeje ideologjike apo politike në interpretimin e veprës letrare, së dyti, na duhet të kërkojmë në të universalet letrare, sepse kemi të bëjmë me një vepër artistike dhe jo me një manifest politik. Është rasti ta theksojmë qysh në fillim këtë pikë sepse edhe disa përcaktime të tjera që janë përdorur për të inkuadruar prozën e Kadaresë, – si p.sh. ai "postmodern" –, nuk na bindin, pasi ose tiparet e marra në shqyrtim për të mbështetur këtë hipotezë të dytë përgjithësisht nuk përputhen me "postmodernizmin" e vërtetë që dominoi narrativën e gjysmës së dytë të shek. XX, ose, nëse ka ndonjë përkim të rastësishëm, ky varet nga vizioni modernist që përqafoi Kadare qysh prej periudhës rinore. Duke lënë mënjanë të parat për shkak të mospërputhjes së tyre, mes të dytave ka disa tipare që ia vlen të ndalemi.

Në veprën e Kadaresë nuk ka asnjë gjurmë të mënyrës së ngurtë, pedante dhe obsesive të përshkrimit të realitetit të jashtëm, pra të mungesës totale të vëmendjes për psikologjinë e brendshme të personazheve, çka karakterizon realizmin fenomenologjik të Alain Robbe-Grillet. Përkundrazi, kujdesi ndaj detajeve që vihet re te Kadare nuk është vetëm në funksion të qëllimit për t'i dhënë gjallëri realitetit, por synon edhe t'ia fshijë shkëlqimin e jashtëm e ta shndërrojë gradualisht në një përmasë shpirtërore, si të ishte zgjatim i psikikës njerëzore përtej kufijve të natyrshëm mendorë. Mjafton të kujtojmë teknikën e "listës", të cilën Umberto Eco, kur analizon kapitullin e parafundit të *Uliksit*, e gjen tek "evokimi i imazheve hapësinore pa u dhënë atyre peshë" (ose, thënë italisht, "annullamento della pertinenza semantica").

Në këtë teknikë të mirëfilltë moderniste e kanë burimin zgjatjet e shumta dhe shtrembërimet kohore, që e prishin rrjedhën lineare të "kohës së rrëfyer" dhe të "kohës së rrëfimit", duke arritur në disa raste vorbullën barthesiane të "kohës-kartë": koha e ngjarjeve që përjetojnë personazhet nuk përkon kurrë as me kohën "realiste" të ngjarjeve, as me kohën "reale" të letërsisë, çka shkakton një efekt tëhuajësimi të ngjashëm me atë që u përpoq të arrinte James Joyce duke bllokuar rrjedhën e kohës. Në shumë romane të Kadaresë këto tema përbëjnë *topos*-e që na shpien sigurisht drejt modernizmit: mjafton të përmendim veprën rinore *Përbindëshi* dhe vijimin e saj *Kështjella*, pa lënë mënjanë kompozicionin e ndërlikuar që karakterizon *Dimrin i vetmisë së madhe*, tek i cili do të ndalemi më poshtë. Po ashtu, përmasa hapësinore te Kadare nuk është kurrë qëllim në vetvete, por lidhet me veprimet e personazheve, duke marrë hera-herës forma të ndryshme: hapësira është gjithmonë në funksion të veprimeve të personazheve dhe mund të pësojë zgjerime që përcaktojnë lakore plastike surreale edhe kur vetë përshkrimi zhvillohet me realizëm.

Pa lënë mënjanë këtu përdorimin e perceptimit shqisor, sidomos të dëgjimit, që e shndërron "zhurmën" në një praktikë ideologjike e cila lidh pikat kyçe të historisë së romaneve të ndryshëm. Mjafton t'u kushtohet vëmendje zhurmave, uturimave, krakëllimave, sirenave, biçikletave, motorëve, pëshpërimave, ulërimave, e do të shihet sesi ndryshon vetë gjendja e personazheve që pësojnë një metamorfozë ontologjike, të cilën Kadare e ka huazuar pa dyshim nga *incipit*-i onomatopeik i *Finnegans Wake* të Joyce-it, pasi ky i fundit nga ana e tij e kishte marrë prej «metaforës zanafillore të qytetërimit njerëzor», për të cilën Giambattista Vico shpjegoi se ndër të gjithë tropet është ajo që «u jep kuptim e ndjenjë gjërave të pakuptimta».

Raportet kronotopike që vendos Kadare në romanet e veta përbëjnë një nga elementet strukturore të karakterit modernist të narrativës së tij. Po të marrim parasysh një nga kryeveprat e tij, romanin *Dimri i vetmisë së madhe*, mund të themi pa ngurrim se ai *do përfshirë në grupin e romaneve urbanë të shek. XX, pasi ndan me disa syresh, si Uliksi i James Joyce-it dhe Berlin Alexanderplatz* i Alfred Döblin-it, ndërveprimin e jashtëzakonshëm dhe të vazhdueshëm mes mjedisit urban dhe banorëve të tij, në rastin tonë, të banorëve të një kryeqyteti periferik e të pazhvilluar si Tirana e viteve '60, që Kadare e shndërron në një metropol modern, plot gjallëri dhe me tipare perëndimore. Një element tjetër strukturor që ia vlen të përmendet është përmasa e veçantë ontologjiko-ekzistenciale e personazheve, të gjithë "në kërkim të identitetit të tyre", një lloj kërkimi, një *quête* autentike ariosteske. Në të vërtetë, falë faktit që ata veprojnë dhe vërtiten në një mjedis urban, është e natyrshme që t'u kryqëzohen rrugët, të këmbehen e të takohen rastësisht me njëri-tjetrin, duke zbuluar kështu fuqinë e përditshmërisë së rëndomtë. Nga kjo pikëpamje koncepti i labirintit narrativ xhojsian forcohet dhe lidhet me një pluralizëm polifonik – një lloj demokracie me shumë zëra – që nga njëra anë i afron disa kapituj të *Dimrit* me kapitullin X të *Uliksit* ku rimitizohet me terma modernë miti homerik i Simplegadave dhe që, nga ana tjetër, ia kundërvë hapur dinamizmin e romanit të Kadaresë njëtrajtshmërisë artificiale, të zvargët dhe statike të doktrinës estetike të realizmit socialist.

Lidhur me funksionin e personazhit kadarean, meriton një shënim të shpejtë edhe arkitektura e romaneve, sidomos vëmendja e veçantë me të cilën Kadare, duke nisur nga *Dimri*, do të realizojë një lloj qarkullimi të brendshëm të historive që rrëfen, të rrethuara thuajse të gjitha nga një *incipit* që zgjidhet vetvetiu në një *explicit* të natyrshëm. Dihet se Kadare, ndoshta pas shembullit të Balzakut dhe të Zolasë a ndoshta, më saktësisht, në hullinë e modelit të Faulkner-it, i zhvendos personazhet nga një roman në tjetrin, a thua se dëshiron të sigurojë vijimësinë kohore të veprimeve të tyre. Kufijtë në letërsi nuk janë kurrë barriera të pakapërcyeshme, madje as kur bëhet fjalë për kufij fizikë, siç mund të jenë subjektet narrative. Nuk është fjala për një truk të parëndësishëm, sepse në disa romane kjo zgjedhje është pjesë e një strategjie narrative që synon të forcojë dhe ta bëjë më tëhuajësues ndërveprimin e diegjezës përmes një efekti *en abŷme* të pafundmë, aq të brendshëm sa të jashtëm. Duke marrë parasysh disa romane, si p.sh., *Ura me tri harqe* dhe sidomos *Prilli i thyer*, lexuesi mund ta vërë re që fillimi dhe fundi i historisë së rrëfyer janë të njëjtë, edhe pse të përmbysur, sikur të ishin përballë një pasqyre. Në një shqyrtim më të gjerë krahazues e njëjta strategji diskursive vu në dukje kompleksitetin e sistemit nervor të universit narrativ kadarean. E kam fjalën për një perandori letrare artificiale, thellësisht vetjake, të pashoqe e ndoshta të papërsëritshme; shumë të ngjashme me *Yoknapatawpha*-n, botën artificiale që Faulkneri quante "my apocryphal county", dhe që duke parafrazuar emrin e përveçëm të shkrimtarit tonë, do të quaj: |*Ismailand*|, nga "(It) *is my land*".

Elementi i fundit është ndërthurja mes legjendës dhe realitetit, mes mitit dhe historisë, që përbën një nga aspektet më karakterizuese të narrativës kadareane falë pjellshmërisë së saj tematike. Miti, legjenda dhe simbolika te Kadare nuk kanë pasur kurrë karakter spekulativ dhe nuk janë kufizuar kurrë në një përsiatje shterpë, tipike për eksperimentet postmoderne. Më shumë sesa një ushtrim i thjeshtë formal, ky përpunim i kërkuar – "i rafinuar" e quan Francesco Altimari – i miteve të kulturës së lashtë shqiptare, larg së qeni vetëm «një kryengritje e mirëfilltë estetike ndaj ortodoksisë ideologjike të realizmit socialist», fiton një funksion tematik organik brenda programit narrativ, duke u bërë një nga shtyllat mbajtëse të gjithë sistemit kadarean, madje një veprimtari e mirëfilltë poietike. Mund të pohojmë pa mëdyshje se, sikurse miti në lashtësi ishte pajtuesi i madh i njeriut me kompleksitetin e padeshifrueshëm të realitetit, ashtu edhe letërsia, sidomos ajo që zhvillohet në kundërvënie me pushtetin, për Kadarenë përfaqëson të vetmen rrugë të

sigurt drejt palingjenezës së shkrimtarit dhe ndërgjegjes së tij artistike. Me fjalë të tjera, për ta thënë me Cesare Pavese-s, pika qendrore për një shkrimtar nuk është të dijë se ka një traditë, por ta kërkojë atë.

Pikërisht këtë ka bërë Kadare kur, duke gjurmuar thellë në traditën gojore shqiptare, gjeti temat, simbolet dhe ideologjemat që do t'i çelin shtigjet forcës së tij krijuese. Jo më kot shprehja e disa tipareve që sot na lejojnë ta përfshijmë veprën e tij narrative në një nënkategori të modernizmit, më saktë në atë të realizmit magjik, varet nga përpunimi i miteve shqiptaro-ballkanike, sidomos të atij *revenant* të cilin e gjejmë qoftë në romanet që e rimitizojnë hapur, qoftë në ato ku ngre kokë si dukuri thuajse paranormale. Nga kjo pikëpamje është me vend përsiatja kritike përmes së cilës Thomas Pavel e ka përfshirë *Doruntinën* në një grup të veçantë veprash, – më saktë *Le chante du mond* (1934) i Jean Giono dhe *La Rue Mantuleasa* (1968) të Mircea Eliade-s – që kanë të përbashkëta tiparet kryesore të të ashtuquajturit «surnaturalisme ethnique». Prania e *turbullimit,* që siç pohon Ato Quayson është një «element themelor i realizmit magjik», është e shpeshtë në romanet e Kadaresë, përfshirë ato që mbahen si më afër estetikës së realizmit socialist. Te *Dimri*, p.sh., ndërtimi i atmosferës surreale ku gjallon rrëfimi *Unheimlich* – dmth. jofamiljar, pra heretik – dhe ku shfaqen fantazma të ndryshme – si ajo e Koçi Xoxes me vrimat e plumbave në gjoks ose si ajo e protagonistit – mbështetet mbi hollësi të tjera tëhuajësuese, që krijojnë gjendje të papajtueshme me realitetin natyror. Qeniet njerëzore provojnë shfaqjen e brengës dhe të ndjesisë së pasigurisë «kur bien – siç thekson Ato Quayson – në një kontekst social të copëzuar e të dhunshëm që përçon mesazhe paradoksale. Në këto rrethana shkohet drejt rrënimit të unit, që zëvendësohet nga një strukturë me natyrë ambigue, e cila mbetet pezull mes ankthit dhe terrorit. Pikërisht ky është vendi i *Unheimlich*-it» dhe ky është edhe rezultati final ku mbërrin njësimi kadarean me një realitet, i cili, duke humbur ngjyresat e normalitetit, dyfishohet për t'u shndërruar në anën e vet absurde, irreale, pra magjike.

Në shprehjen «Realiteti atje dyzohej, shumë shpejt fillonte irealja», që citoj nga *Pallati i ëndrrave* dhe që mund ta konsiderojmë si vetëpërkufizimin më të përshtatshëm të poetikës kadareane, haset përzierja e rrafsheve diskursive dhe sidomos fshirja e kufijve që ndajnë realitetin nga trillimi, përmbajtjen nga forma, deri edhe personazhet nga autori. Këtu ndoshta mund të hasim një element të përbashkët me letërsinë postmoderne, megjithëse mësimi përmes të cilit Jorge Borges parodizonte iluzionin e rremë të John Wilkins-it, na shtyn të mendohemi mbi përpjekjen e kotë për të "kuptuar" realitetin me anë të taksonomive të gjuhës. Është rasti të kujtojmë këtu se edhe për Kadarenë vlejnë metaforat e Flaubert-it dhe të Kafkës: shkrimtari nuk është gjë tjetër veçse urithi flobertian, ose kafsha misterioze kafkiane, që, duke u strukur thellë e më thellë në labirintin e zgavrave që ai vetë gërmon në tekst, ushqen shpresën e kotë të mos zbulohet nga kërkuesit, dmth. lexuesit. Në fakt kush banon në botën e krijimit artistik jo vetëm që e njeh mirë efektin e njësimit të autorit me tekstin – qoftë kur ky përkufizohet në rrafshin e funksionit "gjuhësor" siç bën Michel Foucault, qoftë kur shpallet metaforikisht "i vdekur" në rrafshin ontologjiko-tekstor, sikurse ka vënë në dukje Roland Bathes –, por është në gjendje të ofrojë një interpretim subjektiv shumë më bindës se ato që percepton lexuesi i shkujdesshëm që kritikohet ashpër nga Vladimir Nabokov.

Veprat e Kadaresë janë plot me shenja të qarta që na shpien te roli i autorit në kuptimin modernist, rol i cili luhet në emër të marrëdhënies së ngushtë mes jetës dhe artit që mundon ndërgjegjen e autorit. Në këtë pikë e marrim me mend se Kadare nuk do të pajtohej me ne, por s'ka dyshim se modernistët do të pajtoheshin, duke filluar nga Franz Kafka, që shkrimtari ynë e mban, së bashku me Danten, Shekspirin e Gogolin, si një nga frymëzuesit e tij kryesorë. Tek e fundit besojmë se Kadare do të pajtohet me faktin – e metaforizuar me së miri pikërisht nga Kafka – se germat, para se të shkruhen në kartë, gdhenden nga një makinë torture në mishin e gjallë të shkrimtarit të mbyllur në një qeli të burgut pa mure që quhet Letërsi. Kjo dhimbje e fortë dhe e thellë e bëri shkrimtarin të gjenerojë një vizion modern e t'ia hapë letërsisë së atdheut të tij dritaren që për shumë kohë mbeti e mbyllur. Kjo është merita kryesore e Ismail Kadaresë: t'i ketë hapur shtigje të reja letërsisë shqipe, t'u ketë dhënë modele të suksesshme letrare brezave të rinj, t'i ketë siguruar një të ardhme qytetërimit letrar bashkëkohor. Fjalët tona do të jenë gjithnjë të pakta dhe të pavlera për ta falënderuar këtë shkrimtar të jashtëzakonshëm me të cilin edhe shkruesi i këtyre radhëve është i lumtur të ketë ndarë miqësi dhe bashkëpunim. Edhe "një qind" i dashur Mjeshtër, mik i madh i arbëreshëve!

Kadare në Londër

Nga John Hodgson

Ishte rreth vitit 2010 kur Ismail Kadareja erdhi në Londër. Sapo kishte dalë ‚Aksidenti' në anglisht, dhe botuesi e ftoi nga Parisi për të marrë pjesë një një serë promovimesh, takimesh me lexuesit, etj. Do te qëndronte një javë gjithsej në Angli. Bashkë me një përfaqësues të shtëpisë botuese, e takova në stacionin hekurudhor St Pancras, ku arrijnë trenat nga Parisit që zhbirojnë si uritha nën La Manshin. Zoti Kadare rrodhi sytë në dritën verbuese të stacionit dhe dukej paksa i hutuar nga turmat dhe zhurma e metropolit tonë

M'u kujtua se Anglia dhe Londra nuk figurojnë shumë në krijimtarinë e Kadaresë, përveç në lidhje me Shekspirin, dhe pata dëshirë t'i tregoja diçka nga qyteti, për shembull teatrin e rindërtuar ‚Globe' në bregun e Tamizit. Por botuesi kishte hartuar një program shumë të ngjeshur, rraskapitës.

I ishte caktuar Zotit Kadare një hotel në lagjjen Soho. Ai më pyeti pse Soho kishte një emër të keq. Iu përgjigja se nuk kishte emër të keq, por është lagjja e qejfit dhe prej shekujve u ka ofruar strehim shkrimtarëve, artistëve, piktorëve pijanecë, dashamirëve të kuzhinës së sofistikuae dhe nonkonformistëve të të gjitha llojëve. Hoteli ishte i vogël, por luksoz, dhe përfaqësuesi i shtëpisë botuese na treguan me gisht disa aktorë dhe këngëtarë të famshëm që ishin bashkëmysafirë, dhe u befasua se emrat e tyre nuk na ishin të njohur as Zotit Kadare, as mua. Zoti Kadare u shqetësua nga fakti se botuesi më kishte kërkuar të lëja të gjitha punët e mia për një javë rresht për ta përcjellë në programin e tij, pa asnjë honorar. Kjo i dukej atij i padrejtë dhe më ftoi për drekë në restorantin e hotelit. I thashë se te ‚Aksidenti', të cilin porsa kisha përkthyer, kishte shumë hotele dhe bare luksoze dhe ai më tha se i vinte mirë se kisha vurë re këtë karakteristikë, se i kishte futur me qëllim, që letërsia shqipe të mos jetë vetëm me baltë. Gjatë drekës, më tregoi shumë anekdota për udhëtimet e tij në kohëra të tjera, në Moskë në kohën e ‚shkrirjes' hrushçoviane, në Kinë në kohën e Revolucionit Kulturor, dhe në Vietnam gjatë bombardimeve amerikane, duke kujtuar një botë të zhdukur plot me drama gjeopolitike. Por në fund të fundit lagjja Soho nuk i la Ismail Kadaresë ndonjë përshtypje të mirë, se nuk gjente asnjë kafene të qetë ku mund të shkruante së paku një orë në ditë. Vërtet në zallamahinë e Londrës nuk ka vend që mund të krahasohet me Cafe Rostand-in në Paris.

Besoj se promovimet e librave janë një kënaqësi të veçantë për shkrimtarë fillestarë, të pamësuar me vëmendjen e publikut. Por për shkrimtarë me famë bëhet e mërzitshme të ulin nëpër librari para radhëve të pafundme të lëxuesve që kërkojnë firmën a autorit te faqja e parë, mundësisht me ndonjë dedikim të veçantë. Nobelistja e madhe Doris Lessing refuzonte kategorisht të bënte këtë gjë. Pashë se edhe Zoti Kadare tani ishte ngopur me këto rituale. Patëm takime në librarinë e njohur katërkatëshe Foyles, në sallën e shoqatës PEN International, në Festivalin e Letërsisë në Cheltenham. Cilësia e diskutimeve ishte e ulët dhe pjesëmarrësit shpesh bënë pyetje për politikën e ditës, për bashkimin kombëtar të shqiptarëve dhe për çmime letrare të marra dhe të pamarra. Rrallëkush pyeste diçka lidhur me romane të shumya që kishte nxjerrë Ismail Kadareja. Ai, duke pritur përkthimin tim, me kthente një shikim të lodhur dhe të mërzitur. Edhe unë, i pamësuar të përktheja me gojë para publikut, u ndieva në një pozitë të vështirë, dhe nuk besoj se ne të dy shkëlqyen në këto promovime.

Ka shkrimtarë që komunikojnë lirshëm në shfaqje publike, që ndihen të lirë dhe te çlodhur në një sallë plot me dashamirës të tyre. Por kjo aftësi nuk ështe talent i domsdoshëm për çdo shkrimtar. Ka edhe ata që komunikojnë me mijëra-mijëra lexues në heshtjen e studiove të tyre. I lexojmë ne qetësinë e shtëpive tona dhe atje e zënë vendin në jetën tonë.

Kur përktheja Kadarenë

Përkthimi i poezisë si pjesë e besimit letrar

Nga Mira Meksi

Sa herë flitet për poezinë dhe përkthimin e saj, pothuaj përherë thuhet se poezia bart një lloj dykuptimshmërie: është njëkohshëm universale dhe e papërkthyeshme. Universale, – sepse shpirti njerëzor është i tillë, shpjegojnë, – e papërkthyeshme sepse, me kalimin nga një gjuhë në një tjetër, me ndërrimin e shenjave grafike, ndryshon dhe muzika e saj, elementi thelbësor që ka. Por, përpara se të flitet për përkthim të poezisë, është e natyrshme të shtrohet pyetja e përjetshme: ç'është poezia? Si mund të përkufizohet me pak fjalë poezia? Me gjithë përpjektjet për ta shpjeguar, enigma mbetet. Benedetto Croce thote se poezia është një ndijim i brendshëm, një ngjarje intime në shpirtin e poetit. Ndërsa për Pessoa-n poet, poezia është një përshtypje e intelektualizuar, apo një ide e shndërruar në emocion, e cila u komunikohet të tjerëve, nëpërmjet një ritmi. Në librin e tij me ese "Harku dhe lira" Octavio Paz-i kuturiset e bredhërin lëmit poetik duke u rrekur të japë një përgjigje për pyetjen në fjalë. Me anë të një ligjërimi poetik, bën një përpjekje për të përcaktuar të papërcaktueshmen poezi dhe për të arritur te poezia nëpërmjet vetë poezisë; interesante është të thuhet se një nga instrumentat që ai përdor për të hedhur pakëz dritë brenda labirintit të mjegullt të temës në fjalë, pra, për ta shpjeguar poezinë, është perspektiva e përkthimit të poezisë, e cila përfshihet në atë që cilësohet "përvojë e poezisë" dhe që me fjalë të tjera është rikrijimi i saj…

Po le t'i kthehemi përkthimit të poezisë: është, padyshim një proces i ndërlikuar dhe shumëfaqësh, po të mendohet, përpos të tjerash, se poezia e përdor "fjalën" si një instrument artistik, shpesh jashtë shtratit të saj kuptimor; aq e vështirë është t'ia dalësh e ta përkthesh besnikërisht një "huq" të tillë të poezisë, sa shprehja "Traduttore, traditore" duket se është shpikur pikërisht për përkthyesit e poezisë. Ka zëra që thonë se përkthimi i poezisë, përkthimi i emocionit njerëzor, është një ndërmarrje pothuaj e pamundur, se përkthyesi është i destinuar të dështojë në përkthimin e poezisë, madje, ata arrijnë gjer aty sa ta mohojnë krejtësisht përkthimin poetik; por ka të tjera zëra që thonë se përkthimi poetik pasuron, se e kthen të ndryshmen në të ngjashme, madje, edhe kur nuk e arrin dot këtë, të paktën na sjell në shtëpi atë gjënë e ndryshme që përfaqëson origjinali. Sa për poezinë si shprehje e emocioneve njerëzore, këto zëra thonë se emocionet njerëzore janë, në pjesën më të madhe të tyre, të ngjashme dhe se mund të shprehen në çfarëdolloj gjuhe. Përkthyesi i poezisë duhet të rreket të gjejë kalket përgjegjëse, të afta që të ngjallin emocione të ngjashme te lexuesi. Në fund të fundit, atë që mund të cilësohet si "efekt i kërkuar", nëse do të shpreheshim me gjuhën e Walter Benjamin-it, kur në "Misioni i përkthimit" pohon se " të përkthesh do të thotë të dish të përcjellësh atë çka në një tekst shfaqet si efekt i kërkuar".

Borges-i është në një mendje me ata që shprehen se "çdo gjuhë ka mundësitë dhe pamundësitë e veta", por nuk e pranon përfundimin se përkthyesi letrar është i dënuar të dështojë. Përkundrazi, Borges-i pohon se ndryshimet mes gjuhëve dhe mënyrat e ndryshme të shprehjeve i japin një përkthyesi, që ka për mjeshtëri rikrijimin nga origjinali, mundësi të shumëllojta. Për Borges-in përkthyesi përherë duhet të përdorë lirinë e nevojshme për të arritur atë që çdo shkrimtar kërkon: një vepër letrare bindëse. Përkthimi i poezisë, ndonëse është përherë një sfidë e madhe për përkthyesin, ka njohur arritje të tilla, kur varianti i përkthyer është konsideruar si i të njëjtit nivel me origjinalin: në krye të kësaj liste janë përkthimet në frëngjisht që Baudelaire-i u ka bërë poezive të Edgar Poe-së. Apo përkthimi nga Pessoa në portugalisht i poezive të Poe-s "Annabel Lee" dhe "Ulalume"; "Poezi që i përktheva jo për hir të vetë vlerave që bartin, por sepse paraqiteshin si një sfidë e vërtetë përpara përkthyesve", na thotë përkthyesi.

M'u desh të rendis gjithë sa më sipër për të rrëfyer se në ç'univers të koklavitur e të vështirë u gjenda viteve 1987-88, kur nisa të përktheja në frëngjisht poezitë e Kadaresë, të cilat përmblidhnin rreth tridhjetë vjet krijimtari të autorit; në të vërtetë, e kisha filluar përkthimin e tyre shumë më parë se të më besoheshin "zyrtarisht" prej tij, në kohën kur studioja për filologji frënge. Ishte koha kur besoja në fatin tim prej përkthyeseje letrare, kur dija përmendësh qindra vargje të poetëve klasikë dhe modernë francezë, kur përpiqesha të përktheja në frëngjisht poezi të Nolit dhe të profesorit tim të përkthimit Vedat Kokonës, dhe kur shkruaja vetë vargje në frëngjisht (në të vetmen gjuhë që kam guxuar të shkruaj vargje ndonjëherë), të cilat kishin për lexues vetëm pedagogët e mi francezë dhe shokët e kursit.

Që në krye të herës, ndonëse e kisha të qartë se përkthimi nga shqipja në frëngjisht ishte ku e ku më i vështirë se nga frëngjishtja në shqip, mbaj mend, pata krijuar bindjen se, ndryshe nga besimi i përgjithshëm se përkthimi ishte një "poezidëmtues" a "poezivrasës", përkthimi në vetvete ishte element përbërës i poezisë dhe se poezia lindte dhe gjallonte nëpërmjet tij: poeti kur shkruan poezinë s'bën gjë tjetër veçse "përkthen" emocionet e tij në gjuhën e fjalëve, ndërsa lexuesi bën të kundërtën, "përkthen" fjalët e poezisë në emocione. Madje, ai bën një "përkthim" të dyfishtë: emocionet e përftuara duhet t'i "përkthejë" në kodin, a gjuhën e emocioneve të tij.

Me këtë mendim dashamirës e të ngrohtë për marrëdhënien poezi-përkthim mora në sy sfidën e madhe të përkthimit në frëngjisht të poezive të Kadaresë. Isha, në fund të fundit, një lexues i veçantë i cili, gjuhën e emocioneve që kish arritur të vilte nga poezia e Kadaresë, do t'ia përcillte të ngjashmit të vet francez. Kishte poezi të krijuara përpara se të lindja unë dhe në vise të largëta (mësova që, për t'i përjetuar, t'i klasifikoja në kohët e jetës sime): valë brigjeve të Jaltës, gjire të Rigës, re që mërgonin drejt Suedisë, gra ëndërrore me emrin Birgit, kujtime që ktheheshin në statuja, tunele që nisnin në stacionin Arbatskaia dhe që gëlltisnin njerëzit si gojët e Harresës, dhe Lora… klima e tyre ishte e jashtëzakonshme dhe përjetimi i tyre prej meje, ishte si përjetimi i një jete që e kisha jetuar domosdo, por që më ishte fshirë nga kujtesa – rigjetja e saj më dha shijen e një identiteti të thellë. Pastaj vinin poezi që ishin krijuar aty nga viti i parë i lindjes sime dhe më pas në fëmijërinë time të hershme: tramvaje të pasmesnatës nëpër vende të huaja, orë të ndarjes, gishtërinj malli, të gjatë me kilometra që pleksen flokëve të dashur me gishtërinj të tjerë të huaj, qiej dimri, me një finlandeze në bar, vjeshta që mbron si luan ditët e saj të fundit nga dimri, aeroporti i Rinasit, Luvri, orare trenash…. Pastaj beteja e fushë Kosovës më 1389 dhe gjëma e ballkanasve, dhe alfabetëve të përgjakur, gjuhë të vdekura, marshi i akullnajës, teknika dhe poezia, fusha të dimërta, Sahara dhe drerë qiellorë që përndiqen nga qentë përballë mospërfilljes së yjeve…

Poezia e Kadaresë kishte gjithçka: mendim, ide dhe kumte, mister, simbole, emocion, ritëm fjalësh dhe ritëm imazhor, muzikë, – një klimë e tërë estetike, e cila duhej transplantuar në një tjetër klimë estetike. Kishte poezi ku mendimi apo ideja e Kadaresë duhej transmetuar në frëngjisht me një besnikëri të madhe dhe përpara të gjithave, por, duhej ruajtur me çdo kusht bukuria e të shprehurit. Siç thashë më lart, Pessoa e barazon poezinë me ritmin që ka; ai shprehet: "Ky ritëm është i dyfishtë, njëlloj si anët konkave dhe konvekse të një harku: përbëhet nga një ritëm fjalësh apo muzike dhe një ritëm pamor apo imazhor, të cilët veprojnë në brendësinë e tij. Andaj, përkthimi i një poezie duhet t'i përshtatet absolutisht, e para, idesë apo emocionit që përbëjnë poezinë, dhe e dyta ritmit verbal në të cilin kjo ide apo ky emocion shprehet". "Ajo pjesë e poezisë që godet syrin e imagjinatës së lexuesit nuk ka për të humbur asgjë nga përkthimi në një gjuhë të huaj; ajo që i bën thirrje dëgjimit arrihet vetëm në origjinal" thotë Ezra Pound.

Kishte poezi që mbanin, për hir të rrethanave dhe kohës kur ishin shkruar, një kumt të fshehtë dhe mbeta shpesh në mëdyshjen: Ta bëja më të qartë kumtin për lexuesin francez? A do të arrinte ai vallë ta zbulonte vetë si lexuesi shqiptar, i rregjur në zbulimin e kumteve të fshehta të Kadaresë? Një tjetër vështirësi shfaqej përpara meje: dhënia e pikës së saktë të misterit që mbarte një pjesë e poezive, – as duhej ta rrisja atë, dhe as duhej ta zbardhja. Thuhet se përkthyesi, njëlloj si aktori apo violinisti, vendoset në mes të krijuesit origjinal, autorit, dhe të lexuesit, apo pritësit. Roli i tij është t'i komunikojë këtij të fundit nëpërmjet gjuhës, me sa më pak ndryshime që të jetë e mundur, mesazhin dhe çastin estetik të krijuesit. Duhet të veprojë në mënyrë të tillë që të meritojë titullin e një krijuesi të vërtetë të Artit dhe jo të shërbejë vetëm si një urë. Pra, realisht, më duhej të deshifroja fjalët- simbole të përdorura nga Kadareja për të shprehur mendimet, idetë, kumtet, misteret e tij, të përjetoja dhe të bashkëndaja me të përvojat e tij mistike

dhe pastaj të gjeja fjalët e mia-simbole, me anë të të cilave do t'i jepja lexuesit francez mesazhin e Kadaresë, me një ngarkesë estetike sa më afër origjinalit. Dhe kulmi fare, duhet të sillesha vërtet si krijuese, por duhet të isha vetëm çelësi në dorë të lexuesit, i cili ftohej të hynte në botën e brendshme të autorit; pra, duhet të rrija veç në prag të asaj bote dhe krejt neutrale.

Ishte shumë e vështirë dhe pothuaj e rrezikshme: gjer në ç'masë isha e lirë në artin tim të përkthimit? Gjer në ç'shkallë duhet të isha e përgjegjshme, domethënë gjer në ç'shkallë duhet të isha "e drejtë, e saktë" ndaj autorit? Po ndaj lexuesit? çfarë elementesh të poezisë duhet të sakrifikoja në të mirë të elementëve të tjerë? Sepse pa dyshim "sakrifikime" do të kishte, kur përpara meje ngrihej barriera e rreptë e gjuhës. Nuk kishte rregulla absolute, madje, s'kishte fare rregulla; përgjegjësia dhe liria më shqetësonin shpirtin dhe më turbullonin punën e çdo dite. Duhej vendosur një ekuilibër mes të dyjave, por s'qe aspak e lehtë, përkundrazi, u torturova gjatë mes dyshimeve të gjembëta.

Bëri punë vetëm magjia e poezisë. Isha aq e kredhur në universin e poezisë, aq e mbushur me të, dhe aq shumë jetoja për të, sa dikur ndjeva se isha e "pushtuar" prej saj, gjer në atë pikë sa më ngjante se vargjet që përktheja në frëngjisht, në të vërtet dilnin prej meje që në burim, krijoheshin nga unë, sikur unë të isha vetë autori; ishte një iluzion shpëtimtar që vendosi ekuilibrin e duhur mes përgjegjësisë dhe lirisë së zejes sime: bëri që zëri poetik përkthimor të ish shumë pranë origjinalit. Kisha hedhur mbi supe një fat përunjësie dhe nënshtrimi ndaj produktit të autorit, kisha lënë gjer identitetin tim krijues, kisha përqafuar identitetin krijues të autorit dhe metoda e punës doli të ishte krejt origjinale: i mësoja përmendësh poezitë në shqip, nga leximi i shumëhertë dhe me muzikën dhe mesazhin e tyre në mendje, pastaj, vargjet dilnin vetiu në frëngjisht, edhe në çastet më të pamendueshme të jetës sime: edhe në gjumë. Kishte raste kur lidhësat, përemrat, ndonjë formë foljore hidheshin në erë nga "natyrshmëria" e lindjes së vargjeve në gjuhën frënge, çka prodhonte edhe ndonjë gabim gjuhësor "të detyruar", që Claude Durand-i redaktonte më pas me kujdes.

Në esenë e tij "Mjeshtëria e besimit letrar" Borges-i flet për krijimin letrar si për një besim të veçantë: " ... për credon time letrare mund të pohoj pjesën që ka të bëjë me religjionin: është imja përderisa besoj në të, jo ngase e kam shpikur unë..." Dhe "credo"-ja ime asokohe ishte, pa dyshim, besimi pothuaj religjoz, fetaria ime ndaj realitetit të poezisë dhe përkthimit të saj: ishte i njëjti realitet që ndante autori dhe unë. Dhe i njëjti besim, sigurisht.

Kadareja vinte në Shtëpinë Botuese "8 Nëntori", ku punoja asokohe, me një bllok të numërtuar rreptë ku mbante poezitë që shkruante, shumica të pabotuara, dhe nga ku më jepte syresh në formën e dorëshkrimit për t'i përkthyer. Në fletët e atij blloku ndodhej edhe poezia Sapuni "Ledi Makbeth", e porsashkruar (viti 1987), cila, poshtë titullit kishte fjalën "Antireklamë"... Më goditi përnjëherë: mesazhi i saj ishte i tmerrshëm, trondítës, rrëqethës: sapunin gjakshlyes njerëzimi nuk kishte për ta shpikur asnjëherë, kjo ishte gjëja më e çmuar e tij, krimet nuk shlyheshin kurrë, madje edhe pas katërqind vjetësh... E përktheva poezinë me një ndjenjë të fuqishme të dyfishtë: e magjepsur nga forca e së vërtetës së saj dhe e frikësuar për vdekje për fatin tim dhe për fatin e autorit, – ishim mësuar që "Ledi Makbeth" të quanim nën zë Nexhmije Hoxhën, aludimi ishte fare i qartë, në dritë të diellit, dhe asokohe, vejusha e diktatorit ishte më e fuqishme dhe më e rrezikshme se kurrë. U mata me dhjetëra herë të flisja me Kadarenë e t'i komentoja se, ndonëse poezia nuk do të botohej në Shqipëri, por do të shkonte e do të botohej frëngjisht drejt e në Francë, ai ishte në rrezik të madh (nuk do t'ia përmendja fare frikën që kisha edhe për vete). Por natyrshmëria me të cilën ma dha poezinë e frikshme dhe një lloj moskokëçarje e çuditshme apo një lloj "guximi" naiv, më penguan ta bëja: nuk mori mundimin as të më paralajmëronte që të mos ia rrëfeja kujt dorëshkrimin e poezisë.

E kam vrarë mendjen gjatë kohë më pas se si ndodhi që Kadareja më besoi aq lehtësisht poezinë e rrezikshme.Vite më vonë e pyeta dhe nuk dinte të më përgjigjej, por unë isha tashmë e sigurt: i ishim dorëzuar dhe i përkisnim tërësisht Besimit të përbashkët të krijimit letrar, Credos së Borges-it, i cili bëri të mbeteshim gjallë kohëve të liga që jetuam dhe ruajti nga prishja pjesën tonë më të qenësishme, shpirtin tonë.

18 Shtator 2010

Udhëtimet nëpër Gjirokastër

Nga Dorota Horodyska

Me Ismail Kadarenë nuk kam biseduar kurrë si me autorët e tjerë. Si përkthyese nuk i kam kërkuar të më shpjegojë paqartësitë, nuk e kam pyetur për kontekstet dhe fjalët, nuk jam konsultuar për asgjë. Nuk kisha guxim. As nuk jam përpjekur të rri në shoqërinë e Tij, për t'u ngrohur nga shkëlqimi i famës. Jam ndier e ndrojtur dhe vazhdimisht ndihem e tillë, duke e konsideruar si një Olimp të papushtueshëm.

Megjithatë, kam biseduar dhe diskutuar me Të në mënyrën time, që prej fillimit, që nga çasti kur nisa ta njoh Shqipërinë, historinë dhe letërsinë e saj, që më pas do ta përktheja. Jam përpjekur të deshifroj kodet letrare të veprave të tij, që më pas do të analizohen nga lexuesit polakë. Ata kanë guximin t'i bëjnë autorit pyetje ngacmuese dhe intriguese.

Të tilla janë për shembull pyetjet për Gjirokastrën. Ata e ndiejnë intuitivisht se ky është një lloj qyteti i çuditshëm, i cili nuk hyn lehtësisht në kallëpet e tipologjive. Është qytet që ngjall respekt, ndonjëherë edhe frikë, qytet që provokon dhe trazon.

Gjithçka nisi mbi dhjetë vjet më pare, kur Kadare u propozoi polakëve veprat e tij me titull „Kronikë në gur", "Çështje të marrëzisë", „Breznitë të Hankonateve" si dhe „Darka e gabuar", duke sugjeruar se në këto romane do të gjejnë çelësin për të kuptuar fenomenin e këtij qyteti.

Jam befasuar, se sa të shumtë janë lexuesit, që ndërmarrin një udhëtim të tillë letrar në këtë qytet, të cilin shumëkush do ta quante kulturalisht mjaft të largët prej nesh. Vizitorët e këtij qyteti shtohen nga viti në vit.

Gjirokastra e Kadaresë të grish me misteret, me pleksjen e kohëve historike, me trillin që ndërthuret me jo-trillin. Të josh me bukuritë e jashtme, duke të detyruar të kërkosh atë që fshihet thellë brenda saj. Si Gjirokastra *non-fiction*, si ajo *fiction* e Kadarsë, nuk i zbulojnë lehtësisht misteret e tyre. Gjirokastra është tekanjoze dhe i ndryn ato mistere me mjaft kujdes. Është qytet, të cilin shumica e turistëve mëton ta "njohë" brenda pak orësh, por ndërmjet atyre mijërave që tregohen shpërfillës, do të hasësh në një grusht njerëzish të zellshëm, që do t'u drejtohen rrugëve të këtij qyteti, të prirë nga vizioni kadrejan i qytetit, si nga një lloj udhërrëfyesi.

Janë këta që zbulojnë jo vetëm natyrën fizike të saj, në objektet dhe ndërtesat konkrete, por edhe enigmat, aromat, ngjyrat dhe tingujt si dhe heshtjen që ruhet brenda tyre. Janë ata që kundrojnë shtëpitë dhe odat, vështrojnë me interes orendintë, përpiqen të zbulojnë misteret që fshihen brenda katër mureve. Mundohen të depërtojnë në shpirtin e banorëve të tyre, që do të thotë, të qëmtojnë zakonet, traditat e kultivuara nga njëri brez në tjetrin, por edhe besëtytnitë, namatisjet, sekretet, intrigat, xhelozitë, krimet. Ata kërkojnë të kuptojnë bashkësinë qytetare që ekziston në hapësirën e qytetit, lidhjet mes fqinjësh, veprimtarinë e banorëve, dëfrimet e tyre, vendtakimet, funksionimin e opinionit publik, edhe përmes thashethemeve.

Udhëzuesit letrarë, enigmat dhe fjalitë e Autorit, që nuk thonë të tërën, provokojnë pyetjet e radhës, si për shembull ajo që lidhet me megalomaninë e Gjirokastrës? Mos vallë ajo vjen nga vetmia? Çfarë është vetmia dhe cili është shkaku i saj? Pyetjet shumëfishohen...

Gjirokastra formon një lloj të veçantë lexuesi – një qëmtues letrar të rafinuar. Jo çdokush mund të jetë udhëtar letrar nëpër Gjirokastër. I tillë mund të jetë vetëm ai, që dëshiron të hyjë në marrëdhënie intelektuale me qytetin. Ai që dëshiron të zbulojë jo vetëm misteret letrare dhe jo letrare, por ai që guxon të shkojë më tej – ai që dëshiron të njohë historinë dhe kulturën shqiptare. Por, pa njohur Gjirokastrën, si atë *non-fiction*, si atë *fiction*, nuk mund të njohësh historinë dhe kulturën shqipe. Për të mos folur për letërsinë.

Varshavë, janar 2021



JOHN UPDIKE
Kronikë në gur, një roman magjepsës

"The New Yorker", 14 mars 1988

Shqiptarët njihen për ashpërsinë e tyre, izolimin, ultra-komunizmin, por jo për letërsinë moderne; e megjithatë, Ismail Kadareja, i lindur më 1936, gëzon një reputacion të konsiderueshëm në Evropë dhe libri i tij i parë i botuar këtu ("Chronicle in Stone", përkthyer nga shqipja (përkthyesi anonim), botuar nga New Amsterdam Books / The Meredith Press, $17.95) nuk është një kureshti e radhës, por një roman krejtësisht magjepsës - i sofistikuar dhe i arrirë në prozën e tij poetike dhe në zhdërvjelltësinë e rrëfimit, por gjithashtu i mbështetur në rrënjët e një prej shoqërive më të pazhvilluara evropiane. Kadarenë e kanë krahasuar me Gabriel García Márquez-in dhe të dy shkrimtarët shkruajnë për qytete që ende vezullojnë me magji dhe që udhëhiqen nga mendësia klanore; qyteti i paemër malor i Kadaresë, pa dyshim, i bazuar në qytetin e tij të lindjes, Gjirokastrën, duket më pak tekanjoz se Makondoja i García Márquez-it, më pak i zhytur në surrealizëm.

Qyteti i Kadaresë është i tëri prej guri, "duke nisur nga rrugët dhe krojet e gjer te pullazet e shtëpive të tij të mëdha, shekullore, që ishin të mbuluara me pllaka guri ngjyrë hiri, të ngjashme me ca luspa gjigante", dhe aq i pjerrët, sa "në nivelin e pullazit të njërës shtëpi gjendeshin themelet e tjetrës" dhe një pijanec që rrëshqiste në rrugë mund të përfundonte mbi ndonjë çati. Megjithëse ngjarjet zhvillohen gjatë Luftës së Dytë Botërore, qyteti bart zakone të moçme; fytyrat e nuseve zbukurohen me "pikëzime yjesh, degë selvish, shenja qiellore, që notonin të gjitha në misterin e bardhë të pudrës", ndërsa disa raste magjie i detyrojnë njerëzit të fshehin tufat e flokëve të prera dhe hirin e oxhakut. Vendosja e një shtatoreje në sheshin e qytetit u duket banorëve si një risi ogurzezë: "Një njeri i bërë prej metali! A ishte e nevojshme një krijesë e tillë? A nuk ishte turbulluese? Në kohën që gjithë njerëzit do të flinin, siç e urdhëronte Zoti, shtatorja do të rrinte në këmbë. Ajo do të rrinte ashtu ditë e natë, dimër-verë... Përurimi nuk u bë, për të mos shkaktuar turbullira. Njerëzit shikonin të habitur komitin prej bronzi, me një dorë të vendosur mbi revole, që vështronte i vrenjtur sheshin sikur të pyeste: 'përse nuk më deshët?'.

Gjatë natës, mbi supet e njeriut prej bronzi dikush kishte hedhur një velenxë leshi. Qysh atëherë qyteti u dashurua pas shtatores së tij." Kur një ushtar grek e qëllon shtatoren në kofshë, njerëzve "u dukej se po shqeponin. Sytë ishin të turbullt. Disa po shqeponin vërtet..."

Animizmi i gjithëpranishëm është dyfish më i fuqishëm te ndjeshmëria e një fëmije pa emër në qendër të romanit. Ai antropomorfizon pikat e shiut tek flasin në ulluk, si dhe rezervuarin poshtë shtëpisë ku ato derdhen: "Unë e doja shumë sternën dhe shpesh i flisja gjithfarë gjërash, duke u përkulur në grykën e saj. Ajo kishte qenë gjithmonë e gatshme të më përgjigjej me atë zërin e saj të zvargur e të thellë...". Në përfytyrimin e këtij djali qyteti është një krijesë e gurtë që mbahet me thonj pas malit, rrugët kacavirren, rrokullisen, përplasen me njëra-tjetrën ("nga përplasja të dyja ishin shtrembëruar") dhe aeroplanët e luftës, që stërviten në një pistë diku afër, duket sikur janë personazhe të gjalla. Këndvështrimi egocentrik dhe metaforik i një fëmije krijon poezi të pashterueshme:

Reja e vogël në qiell ecte si e dehur përpara. Tani ishte bërë e gjatë dhe e hollë. Jeta e qiellit duhej të ishte shumë e mërzitshme në verë. Ngjarjet në qiell tani ishin të rralla. Reja e vogël që kaloi përmes, siç kalon njeriu përmes sheshit të shkretuar nga vapa e mesditës, u tret pa arritur veriun. Kisha vënë re se retë vdisnin shumë shpejt. Kufomat e tyre endeshin për një kohë të gjatë nëpër qiell. Nuk ishte e vështirë të dalloje retë e gjalla nga retë e vdekura.

Rrëfimi përshkohet nga zëri i pafajësisë dhe nga moria e thashethemeve, por kapitujt gërshetohen me fragmente nga gazetat, njoftime dhe kronika historike. Italianët e pushtojnë qytetin, duke sjellë me vete murgesha, një shtëpi publike dhe një pistë avionësh; pastaj qyteti bombardohet nga britanikët; grekët e pushtojnë përkohësisht; italianët rikthehen dhe sërish zmbrapsen; partizanë shqiptarë të grupimeve politike të ndryshme zbresin nga kodrat; dhe, së fundmi, qyteti pushtohet nga gjermanët. Shumica e banorëve arratisen para se të vijnë gjermanët dhe pastaj kthehen ngadalë. "Mishi i butë i jetës po mbushte përsëri zhguallin e gurtë." Kronika përfundon me pushtimin gjerman, sikur toni i saj i mrekullueshëm i një fabule fëminore të mos mbahej më dot gjallë nga kujtesa. Një zë i rritur na thotë në fund: "Erdha prapë pas një kohe të gjatë në qytetin gri të pavdekshëm. Këmbët e mia prekën me druajtje shpinën e udhëve të tij të gurta... Nëpër qytete të huaja, duke ecur nëpër bulevarde të gjera dhe plot drita, më ka qëlluar shpesh të më pengohen këmbët atje ku s'pengohet askush. Kalimtarët kthenin kokën të habitur; por unë e dija, ishit ju. Ju dilnit papritur nga asfalti dhe pastaj fundoseshit prapë në thellësi të tij".

Na lind dëshira të dimë ku janë këto bulevarde të huaja dhe se si Ismail Kadareja ka mundur të krijojë



një art kaq të rafinuar dhe kaq të lirë shpirtërisht nën regjimin famëkeq, shtypës dhe ksenofobik të Hoxhës. Hoxha përmendet në një kapitull të mëvonshëm si një udhëheqës i rezistencës, që kërkohet për t'u kapur dhe si një ish-banor "i mirësjellë" i qytetit, por pa lajka apo ndonjë nderim të dukshëm. Valët e fuqive luftuese, që zaptojnë qytetin njëra pas tjetrës, shfaqen, ashtu si edhe tekat e motit vetëm nëpërmjet pasojave në terren, dhe personazhet komuniste bashkohen në brutalitetin shkatërrimtar pa mundur të shkëputen e të dalin mbi të. Copëzat e prozës midis kapitujve, në vetën e parë, e shndërrojnë rrëfimin në një përplasje graduale të armiqësive të vjetra dhe sloganeve të reja. Ngjarja më e zymtë është ekzekutimi nga ana e gjermanëve i kako Pinos , gruas së vjetër që zbukuron nuset dhe që ndalohet nga një patrullë teksa shkon në një nga ato dasmat, që mrekullisht dhe marrëzisht vazhdojnë të bëhen mes bombardimeve dhe pushtimive. Na krijohet përshtypja se magjia e saj piktoreske, në dukje, zhduket, por edhe në mënyrë të pariparueshme, nga faqja e dheut.

Për statusin e autorit në Shqipërinë e Pasluftës dimë vetëm çfarë na thotë faqja e brendshme e kapakut të librit - që romani "Kronikë në gur" është botuar fillimisht në Tiranë, kryeqyteti i vendit të vogël të mbyllur, në vitin 1971. Kadareja na çon në gjirin e një vendi ku fare pak të huaj mund të shkojnë, por ai nuk u jep shumë rëndësi ekzotizmave myslimane të Shqipërisë - xhamitë, ferexhetë, emrat ortografikisht të çuditshëm, si Xhexho, Selfixhe dhe Vehip Qorri. Madje, qyteti i tij i gurtë paraqitet si një analogji bindëse e fëmijërisë së çdokujt - miqësor deri dhe në misteret e tij, i vyer deri dhe në vuajtjet dhe barbarizmat e rrëfyera. Kujtimet nostalgjike, sigurisht, përbëjnë një strehë të sigurt për një shkrimtar nën totalitarizëm (siç janë edhe përkthimet, librat për fëmijë dhe romanet historike). Ismail Kadareja, na thotë kopertina e librit, pasi ka bërë emër si poet, "ka gërmuar ngjarje historike të mesjetës dhe të kohëve moderne, legjendën dhe realitetin" në nëntë romane. Kur këta libra të botohen në anglisht, do të jetë interesante të shohim nëse ata kanë drejtpeshimin e shkëlqyer dhe larminë e natyrshme të këtij romani, apo, nën presionet e një regjimi vigjilent, kanë rënë në naivitet fals dhe në stilizime të kujdesshme.

Përktheu Elidor Mëhilli

Për shume vjet, Maestro!

Nga Marius Dobrescu

Takimi im me veprën e Ismailit është një histori e gjatë. Pasi erdha në Bukuresht si student i Fakultetit të Historisë – isha pra në vitin e parë, na thirrën te Ministria e Punëve të Jashtme, mua dhe Filip Teodoreskun (i cili ka qenë dhe ambasador i Rumanisë në Tiranë në fund të viteve '90), për të na dërguar në Tiranë, ku të vazhdojmë studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe. Në atë kohë MPJ kishte nevojë për specialistë në disa gjuhë të huaja, shqipja duke qenë njëra prej tyre. Kam pasur kolegë të fakultetit të cilët në të njëjtin vit kanë vajtur shumë larg në Azi: në Vietnam, Korene e Veriut, Mongoli, ose më afër, në Bullgari. Ne të dy patëm fat: Shqipëria ishte, nga ana gjeografike, një vend europian, megjithëse pushteti komunist nuk ishte larg diktaturave aziatike. Në qershor të vitit 1971, duke zbritur nga avioni në aeroportin e Rinasit, para nesh hapej një botë e panjohur dhe mjaft misterioze. Ishte bota shqiptare. Ashtu që vazhdova në Tiranë, për katër vjet, Fakultetin e gjuhës dhe letërsisë shqipe, ku, midis të tjerëve, patëm si profesor Ismail Kadarenë, i cili jepte mësime mbi letërsinë perëndimore bashkëkohore. Duke e njohur personalisht dhe duke i studiuar librat e periudhës së parë, ata të viteve '70, u dashurova me krijimtarinë e tij, ashtu që në fund të studimeve tema e diplomes sime – me profesor Ali Xhikun – ishte mbi rezistencën e popullit shqiptar gjatë shekujve të pasqyruar në romanet e Kadaresë. Pasi i dhashë të gjitha provimet u ktheva në Rumani me një valixhe të mbushur me libra. Këtu vazhdova leximin e romaneve të tij dhe pata korrespondencë me të, ashtu që pas 12 vjetësh e mora përsipër ta përkthej romanin e parë, "Kronikë në gur" (1983), i cili u prit me entuziazëm nga publiku rumun. Ishte romani i dytë i Ismailit në gjuhën rumune, pas "Gjeneralit të ushtrisë së vdekur", varianti i Foqion Miçaços, qe doli në vitin 1973. Që nga viti 1983, kur doli nga shtypi libri im i parë, kam përkthyer në gjuhen rumune gati 30 vellime të Ismailit, me mbi 50 vepra te ndryshme, pa përmendur vjershat dhe dramatizimet pas romaneve të tij. Dihet se ai nuk është një shkrimtar komercial. Se vepra e tij i drejtohet një lexuesi të kulturuar, ndaj edhe nuk ka një numër shumë të madh lexuesish. Por keta janë njerëz specialë, te kulturuar, pasi vetëm ata mund ta kuptojnë metaforikën dhe filozofinë e tij.

Puna në ambientin e letërsise shqipe më është bërë një natyrë e dytë, ashtu që përveç Kadaresë jam marrë me veprat e shkrimtarëve të tjerë. Por Kadare është patjeter shkrimtari përfaqësues i letërsisë shqipe. Ambasadori më i mirë i kësaj letërsie, me siguri ambasadori më i mirë i Shqipërisë në botë. Dhe unë krenohem me veprën dhe miqësinë e tij. E di se pas Shqipërisë dhe Francës, Rumania është në vend të tretë të botimeve të këtij shkrimtari.

Për të konkluduar, mund të them se puna ime në lëmin e letërsisë shqipe, kryesisht me veprën e Ismail Kadaresë, më solli shumë kënaqesi. Shpirtërisht ne radhë të parë. Jam krenar të them, pra, se kënaqesia ime më e madhe është ajo e vitit 2012, kur prezidenti shqiptar Bujar Nishani më ofroi Medalien e Mirënjohjes, e cila kurorëzon një karrierë prej 38 vitesh pune të kushtuar letërsisë dhe kulturës shqiptare në Rumani.

Në këtë fillim të vitit 2021 mund t'i them mikut tim Ismail Kadare vetem disa fjale: Për shumë vjet, Maestro, me shëndet dhe fuqi krijuese!

NË QENIEN LETRARE

nga Bashkim Kuçuku

Qenia letrare e gjithë brezave, që erdhën në vitet 1960 e më pas, ka në vetvete ndikimin e madh të veprës dhe të personalitetit të Ismail Kadaresë, të cilat ishin gjedhja më e lartë për ambicien e çdo shkrimtari të ri. Në atë kohë varfërie lëndore e kulturore, me përjashtim të ideologjisë së tepërt, dhe në rrethanat e mbylljes shoqërore, letërsia ishte arti më i përhapur, të cilin mund ta merrje, madje, dhe ta gjeje, thuajse, kudo në qytet dhe në fshat. Kështu, sytë ishin te shkrimtari dhe letërsia. Prej tij prisnin kënaqësinë, që rrallë e gjenin, p.sh., në filma. Për këtë rol intelektual e shpirtëror vlerësohej dhe respektohej shumë, deri në adhurim nga të pasionuarit. Adhurohej Petro Marko, shkrimtar dhe veprimtar hero i luftës, çmohej Dritëro Agolli e Fatos Arapi, por atë çfarë ëndërronin të bëheshin shkrimtarët e rinj mishërohej tërësisht te Kadareja. Kush nuk dëshironte ta dëgjonte, jo aq në konferenca, se sa në biseda të zakonshme. Si fliste, ç'gjeste bënte, si vishej, fliste gjithmonë për letërsinë, apo, edhe për rëndomësitë e jetës? Prandaj, sa shfaqej diku, dikush a disa e ndiqnin prapa për ta parë e dëgjuar. E, të kishe mundësi, vërtet fatin, të dilje shetitje me të, në mbrëmje, sikurse dilte ai në *Shetitoren e Kombit*, ishe bërë vetiu i rëndësishëm, «i magjizuar» për shokët e shoqet, të cilët, ato që kishin dëgjuar prej teje, u a përcillin të tjerëve gojë më gojë, me shtesa e përshtatje sipas pëlqimeve te tyre.

Ishim një treshe e pandarë me Petro Çekrezin dhe Foto Malon, të dy gjirokastritë. Petrua ishte poet me ndjeshmëri të hollë lirike, edhe se lexonte në rusisht, degë për të cilën studionte, edhe në greqisht. Foto Malo ishte poet, që besohej me të ardhme. Nëpërmjet atyre, që kishin mundur të hynin, sado rastësisht, në "rrethin e tij" të dëgjimit, ndiqnim se ç'thoshte e ç'bënte Kadareja, për t'a përngjasuar në gjeste e të thëna. Petrua ishte i shkathët. Kishte gjetur mundësinë t'i thoshte kush ishte, se ishte nga Gjirokastra dhe studionte për gjuhë ruse, dy të dhëna intimizuese me të. Dhe ishte lumturuar, që kishte ecur në shetitore me të, dhe ne e pamë, që kishte pasur mundësi të bisedonte në oborrin e Lidhjes së Shkrimtarëve (atëherë shtëpia vilë e Musa Jukës). Diçka prej "lumturimit" të tij sikur na ra në fytyrë edhe ne, shokëve të ngushtë.

Cikli i Ligjëratave të tij për letërsinë "dekadente" ka qenë ngjarje e pa të dytë. Sillte erë Perëndimi, lirie, që, për ne, thjeshtëzohej, të shkruash ashtu si mendon, e kundërta e asaj që jetonim. Për një shprehje të pa kontrolluar, le të ishte dhe me gojë, bëheshe objekt kritikash në organizatën e rinisë. Shkonim për të dëgjuar kritikën, dhe merrnim vesh ç'ndodhte përtej murit, si ishte letërsia. Auditori i madh i katit të dytë të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë në të cilin ishin edhe degët e gjuhëve të thuaja, mbushej përplot me studentë nga të gjitha degët. Kursi ynë e kishte orë mësimi në programin e lëndës, prandaj rrinim ulur, të tjerët në këmbë, nga fundi i sallës majë tryezave dhe të dy portat të hapura me mesoret mbushur me studentë, që zgjasnin qafën për të parë. Natyrisht, "dekadentët", sidomos ata francezë e rusë «revizionistë», i kritikonte, ndonëse, me fjalë të përgjithshme etiketuese. Mirëpo, mënyra e paraqitjes, ishte e stërholluar, një lloj arsyetimi sofistik, që jepte efektin e kundërt të qëllimit. Ne na pëlqenin mendimet e bëmat e personazheve, p.sh., dialogjet e monologjet e dramve, bie fjala, të Beketit, ndiqnim me vëmendje citimet e vargjeve të poezive, të cilat i mbanim shënim, disa i mësonim përmendësh për t'i recituar me shokë sipas gjendjes sonë psikologjike dhe situatave studentore.

Ndryshe nga perceptimi im adhurues, në rini dhe vite më vonë, kur fillova punë në gazetën *Drita*, me Kadarenë jemi parë "me hënë jashtë". Nuk kishte ndonjë shkak të njëmendët, as prej tij dhe as prej meje. Shkaku ishte jashtë nesh, kryeredaktori, që, e godiste, me metoda tinëzare nëpërmjet gazetës, dhe fshihej. Unë nuk kisha ndonjë rëndësi, që, ai, të merrej me mua. Por, detyra ime e redaktorit të kritikës letrare, që organizoja dhe përgatisja rubrikën, më jepte një lloj rëndësie. Prej meje kalonin edhe shkrimet për veprat e tij, me lavdërime, me kritika, herë-herë të hidhura a me vlerësime të cunguara me paramendim. Në se për veprat e autorëve të tjerë kisha të drejtën e porositjes së shkrimit, për Kadarenë, dhe për ndonjë vepër që ishte "e shkarë" merrej kryeredaktori, i cili këshillohej me Drejtorinë e Shtypit dhe me kryetarin e Lidhjes. Të porositurit i shpjegoja kërkesën "pako të gatshme" nga kryeredaktori dhe numrin e faqeve daktilografike të shkrimit. Mirëpo, disa herë kryesia e Lidhjes dhe Drejtoria e Shtypit, ishin ankuar, se vlerësimi a kritika qenë të pamjaftueshme, dhe e kundërta, të tepruara. Ngado të shkonte kahja, kryeredaktori, i a hidhte fajin redaktorit. Kryesia nuk e shtynte më tutje. Kadareja e merrte për të mirëqenë. Kritikuesi a gjymtuesi isha unë. Veç vërejtjeve të shpeshta nga lart dhe nga kryesia, pikërisht, për një vepër të tij, më dhanë edhe vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna, të shënuar në kartën e regjistrimit, në biografi. Vetëm për *Pashallarët e kuq/ Në mesditë Byroja Politike u mblodh*, e hodha pa u lagur. Isha kundër botimit.

Keqkuptimi u hoq me ndërhyrjen e dy kolegëve miq, që e dinin situatën. Në një bisedë në shtëpinë e tij (e para herë, që hyja në atë shtëpi dhe bisedoja me të) i a sqarova si ishte e vërteta. Që të bindej më bëri pyetje.

Iku keqkuptimi, por ai, kishte të drejtë për një lloj mërie ndaj meje. Sa kohë punova te *Drita* kam shkruar vetëm një shkrim për librat e tij: *Autobiografia e popullit në vargje*, botim i dytë, dhe për asnjë roman (në ato vite kanë dalë: *Pallati i Ëndrrave*, *Prilli i thyer*, *Ura me tri harqe*, *Muzgu i perëndive të stepës*, *Kush e solli Doruntinën*).

Isha mes kundërshtish. Romanet e tij të rëndësishëm ishin të ndërlikuar, me shprehësi të shtresëzuara, me poetika të ndryshme, të cilat, me formimin e atëhershëm teoriko-letrar, nuk mund të interpretoheshin në shkallaren, që meritonin. Nga ana tjetër, ata gjithmonë kishin domethënie tej cakut të lejueshëm, sikurse dihet, qëndrime të kundërta politike dhe përftesa moderniste. Të shkruaje për to ishte me rrezik për kritikun, dhe rrezik akuze për autorin. Gjithashtu, ishte mendimi dhe praktika, që shkrimtarët e kritikët, punonjës në Lidhje dhe në organet e saj, mos të shkruanin për njëri tjetrin, se ngjante si personalizim i tyre, dhe servilizëm ndaj drejtuesve. Me që për vete nuk e pranoj shëmtimin e servilizmit, ky qëndrim i përshtatej natyrës sime.

Ditën që kërkoi strehim politik (tetor, 1990), në Francë, e morëm vesh fillimisht nga *Zëri i Amerikës*. Radio-Televizioni Shqiptar dhe gazetat dhanë formulimin zyrtar, duke e cilësuar "tradhëti". Jehona te rinia dhe mijëra të tjerë ishte e jashtëzakonshme. Besonin, se qëndrimi i tij do të ndihmonte në rrugëzgjidhjen e situatës politike, që vërtitej në rreth të mbyllur. Pati të tjerë që ishin të bindur se "tradhëtoi", se me kohë kishte qenë "agjent" i Perëndimit.

U fol atej këtej, se do të hiqej nga programet shkollore. Tepër irrituese. Do të hapej një humnerë në letërsi dhe në përjetimin shpirtëror të shqiptarëve. Me që isha pedagogu i lëndës *Letërsi shqipe bashkëkohore*, në *Universitetin e Tiranës*, më thanë kinse rastësisht e shkarazi, që do të hiqej nga programi universitar. Shpreha habi e kundërshtim. Mendimi m'u shpreh edhe në departament në një gjysëm mbledhje, ku "qëlloi" të ishin disa kolegë. Përsëri shpreha habinë time të njëmendët dhe kundërshtimin me argumente. U bëra trim! E kisha vendosur me veten time, në se vërtet do të hiqej nga programi, do të largohesha nga universiteti. Në ecurinë e programit të lëndës, tetor-nëntor, ishin muajt që zhvilloja në auditor, pikërisht, veprat e tij. Prisja me ankth. Nuk e di çfarë ngjau në hierarki. Vazhdova ligjëratat dhe seminaret të plotë. Interesimi i studentëve, afrimi dhe intimizimi i tyre ishte si asnjëherë. Kam hamendësuar, se informacionet, që shkonin lart, tregonin, sikurse ka qenë, mbështetjen e madhe të mbarë rinisë studentore për qëndrimin e Kadaresë. Atëherë kishte studentë veprues përkadareanë, më të dalluarit, në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, ishin Blendi Fevziu, Ben Blushi, etj. Nëpër auditore, në mure e banga, në mesore e në muret e jashtme të ndërtesës së fakultetit shkruhej dhe gdhendej emri i tij, edhe në anglisht, me ndonjë epitet.

Bisedat e çpenguara janë prej vitit 1992, në kohën e mendimit të lirë, pasi u kthye prej strehimit politik në Francë. Më parë, nën censurë, me sa kam vërejtur, ai shoqërohej e bisedonte hapur jo me shumë shkrimtarë, me të besuarit. Rrjetin e spiunimit e ndjente së largu, dhe ruhej. Tanimë, janë botuar qindra letra denoncuese për të, me emër dhe pa emër. Pas rënies së sistemit mbikqyrës, sidomos në vitet e para të pluralizmit, shtëpia e tij te *Rruga e Dibrës* ishte kthyer në një *Sallon Kulture*, që Shqipëria nuk e ka pasur asnjëherë. Hynin e dilnin, gjatë gjithë ditës, prej orës 10.00-11.00 të paraditës deri në orët e vona të natës, shkrimtarë, artistë të çdo fushe, regjisorë, aktorë, kameramanë, gazetarë, profesorë, akademikë, ingjinierë, arkitektë, mjekë, deputetë, politikanë nga Shqipëria, Kosova e troje të tjera shqiptare, gazetarë e kineastë të huaj. Sipas përbërjes së grupeve, edhe bisedat ishin të fushave nga më të ndryshmet. Zotëronin bisedat, informacionet, debatet për politikën, politikanët e deputetët, për qëndrime dhe hollësi groteske të bëmave të tyre, thashetheme komike, për funksionin e institucioneve kulturore, klanet, redaksitë e gazetave dhe televizioneve. Kur vinin gazetarë për ta intervistuar kalonte në dhomën tjetër, nga Jugu, ku ishte biblioteka. Me ata që donte të bënte bisedë të qetë u thoshte:

- Eja në këtë, ose, në atë orë, se ka më pak njerëz.

Sikur, edhe disa ditë të ishin regjistruar të filmuara, do të ishte një lloj arkivi i gjallë me portretin e tërë atyre shkrimtarëve dhe artistëve, intelektualëve, politikanëve dhe deputetëve, me mendimet dhe debatet mes tyre, të njëmendëta e të papërsëritshme.

Më ka befasuar mirëbesimi i tij i sinqertë. Në fillimvitet 1990 i kërkova, mundësisht, të hulumtoja në bibliotekën e shtëpisë botimet e veprave të tij në gjuhë të huaja.

- T'i shikosh, më tha, por jo tani, se ka shumë hyrje e dalje. Kur ne të shkojmë në Francë punon i qetë.

Thirri motrën, zonjën Kadrie dhe i la porosi.

Përse mirëbesim, madje i sinqertë. Të rrëmoja pa praninë e tij?! Biblioteka nuk është thjesht radhë librash. Është vend intim, mund të ketë dhe dokumente vetiake…

Kam punuar disa ditë. Me atë rast u njoha edhe me bibliotekën e tij. Sado kudo, krijova një mendim, se çfarë lexonte dhe pëlqente, sidomos në rusisht, frëngjisht dhe përkthime në shqip të letërsive moderne, të ndaluara në Shqipëri, botuar nga *Rilindja*, në Prishtinë.

Më ka befasuar edhe dashamirësia.

Në një vizitë në shtëpinë e tij, në Tiranë, pa pritur më afroi diçka, që as e kisha menduar:

- Do të të jap ca gazeta dhe revista me shkrime për veprat e mia? Ti të duhen, punon me to.

Studiuesit i u luten shkrimtarëve dhe rrallë mund të përfitojnë nga arkivi vetjak i tyre.

Vite më vonë, duke biseduar në banesën e tij në Paris, përsëri e njëjta "dhuratë":

- Kam ca materiale me shkrime për veprat e mia, atje rrinë, kot. Po janë shumë. I merr dot? Se është me avion.

U entuziazmova. Dhe, vërtet ishin shumë.

Tiranë, 23. 01. 2021

Çifti Kadare, studiuesi dhe kritiku Bashkim Kuçuku, dhe botuesi Bujar Budhri, në restorant Piazza, pranverë 2001

Besimi te letërsia e Kadaresë i ngjashëm me besimin te hyjnia

nga Bujar Hudhri

Kur fotografi i njohur Roland Tasho më tregoi kopjen e parë të albumit të tij të sapobotuar me fotot bardhezi për vizitën e Kadaresë në Gjirokastër, aty nga viti 2000, befas provova ndjesinë kur brenda je ngrohtë në dhomë dhe sheh se si jashtë bie shi, bën ftohtë. Kishim ardhur në qytetin e tij të lindjes, sepse Kadareja ishte shpallur Qytetar Nderi dhe tani ky titull do t'i dorëzohej nga bashkia. U nisëm herët atë ditë me makinë vetëm me Rolandin, sepse Kadareja me zonjën Helena do të mbërrinin me helikopter nga Tirana. Kisha marrë me vete një sasi librash të Kadaresë, botime të miat dhe në gjuhë të huaj. Kisha menduar që në sfond të Kadaresë të ishin librat e tij dhe jo ndonjë flamur partie. Ceremonia u zhvillua në një sallë të madhe të bashkisë dhe nga larg ndiqja portretin e tij që nuk i lëvizte asnjë muskul, ndërsa dëgjonte lumin e lëvdatave nga ata që rendnin ta merrnin fjalën njëri pas tjetrit. Kur mbaroi ceremonia, iu sulën stendës me libra dhe pothuaj i morën të gjithë. S'kisha qenë asnjëherë në atë pozicion që të bëhesha shitës i librave dhe nga larg ndieja vështrimin qortues të Kadaresë. "Ç'më rrije si tutkun, t'i morën librat falas", - më tha kur po largoheshin të gjithë. Nuk i fola asgjë dhe nuk mund t'ia shpjegoja se si edhe unë isha përfshirë në atë turmë, thua se edhe unë isha vetë një lexues si ata.

Pasdite kryetari i bashkisë, Ylli Asllani, organizoi një takim me Kadarenë në sallën e kinemasë. Isha ende i mpirë nga ajo gjendje ku kaloi ceremonia dhe ja tani, në një presidium së bashku me çiftin Kadare dhe Yllin. Një dialog me pyetje e përgjigje të mençura, një atmosferë gati magjike, kur befas nga mesi i sallës ngrihet një zonjë. Pasoi heshtje dhe u ndie zëri i saj, në fillim i dobët:

- Ju botoni vetëm tek Onufri, - u duk se po e qortonte ajo Kadarenë.

Me sa duket, Kadareja nuk e dëgjoi mirë, ndaj vuri dorën te veshi. Tani zëri i zonjës u bë më i fortë:

- Ju shkruani vetëm për Onufrin?

Kadareja iu kthye me një zemërim:

- Nuk të kuptoj, çfarë thua?

- Si e zgjodhët Onufrin si botues? - u dëgjua krejt qartë zëri, ndërsa salla mbante frymën.

- Si e zgjodha? Fare rastësisht, - e mbylli gjithë bezdi këtë dialog Kadareja.

E ndieja se po më thahej goja dhe doja të ndërhyja. Po si? Mund të bëhej edhe më e ndërlikuar situata. Më është fiksuar një shprehje e Kadaresë, ku thotë pak a shumë: "Nganjëherë, kur dëshiron t'i shpjegosh gjërat, i bën më lëmsh."

Dola i dërmuar nga salla, kur shoh të afrohet kolegu im i Toenës, Fatmiri.

- E pe? Të kam thënë që nuk ka respekt për ty. Por ti je i sëmurë pas tij. Ndërro sjellje.

Ishte hera e parë që nuk i thosha Fatmirit që i sëmurë je ti që nuk do artin e madh, jo unë. Por atë ditë i dhashë të drejtë, i lodhur siç isha nga gjitha ajo rrugë deri në Gjirokastër, nga tensioni i marrëdhënieve me një autor të madh dhe unë si një botues i ri, mbase të gjitha.

Të nesërmen në mëngjes e përcollëm te helikopteri. Kur po ngjitej në kabinë, më kujtoi të merrja në makinën time një pikturë të mbuluar, dhuratë nga një artist vendas.

- Kur po ktheheshim në Tiranë, në një kthesë gati na nxore na rruga, - më thotë Rolandi teksa shfletojmë albumin ku në disa prej fotove jam edhe unë me Kadarenë.

Sapo mbërrita natën vonë në Tiranë, siç isha, u drejtova për tek apartamenti i Kadaresë. I vura përpara pikturën e mbuluar dhe ai nga padurimi e grisi letrën e trashë që shërbente si ambalazh. Ishte një pikturë në format të madh. Në qendër ndodhej kalaja dhe, sikur të ishte një triko model golf, ajo rrethonte qafën e Kadaresë dhe portreti i tij të kujtonte pikturat kineze me Mao Ce Dunin me kokën mbi re.

- Ç'është kjo idiotësi? Merre flake në kazanin e plehrave kur të dalësh, - më tha. Pastaj m'u drejtua qetësisht: - Harrova të të pyesja dje, kush ishte ajo femër me ato pyetje idiote? Ndonjë e njohura jote?

- Nuk jam nga Gjirokastra. Nuk njoh njeri atje përveç jush, - munda t'i thosha.

E ndieja që më ishte tharë pështyma dhe nuk guxoja t'i kërkoja një gotë ujë, sepse nuk kishte njeri tjetër në shtëpi. Doja t'i thosha se ende nuk e besoja që isha botuesi i tij, por vetëm një adhurues që nga fëmijëria i veprës së tij. Madje, nuk e konsideroja as banor të kësaj toke, sepse takimet tona ishin vetëm pritje dhe përcjellje në Rinas. Apo edhe tani në Gjirokastër. Vajtje-ardhje me helikopter, nga qielli, ku pas disa çastesh të humbet nga sytë.

Megjithatë, kolegu im i çmuar, Fatmiri, tre muaj më pas, ndërsa po përcillnim Kadarenë nga Panairi i Librit në Paris, në radhë për të pritur taksinë e tij, i tha:

- Dëgjo, Ismail, botues si Bujar Hudhri ti nuk gjen në botë.

Pasoi një heshtje e thellë. Askush nga ne nuk miratoi apo kundërshtoi.

Shumë vjet më vonë, përsëri në Gjirokastër, kemi ardhur me çiftin Kadare që të shohim shtëpinë e tij të rindërtuar. Në drekën solemne që shtroi bashkia rastisa në tavolinën e përkthyesve nga e gjithë bota që kishin ardhur të ftuar nga Akademia e Shkencave. Kuriozitetit të tyre se si isha bërë botuesi i Kadaresë iu përgjigja:

- Në fakt, kisha ëndërruar gjithmonë të isha aq i zoti në një gjuhë të huaj sa të bëhesha përkthyesi i tij. Si një Jusuf Vrion, për shembull. Por, megjithatë, edhe botuesin e krahasoj pikërisht me përkthyesin. Edhe botuesi është një ndërmjetës midis autorit dhe lexuesit. Por, duke qenë ndërmjetës, është edhe një pengesë, apo jo? Ja, ne po flasim shqip dhe merremi vesh pa përkthyes. Ashtu sikundër lexuesi do të thoshte: sa bukur është përkthyer, sikur të jetë shkruar në gjuhën tonë! Ndaj synoj si botues të jem i padukshëm, që shkrimtari të duket sikur komunikon vetë me lexuesin, pa asnjë ndërmjetës.

Sot që po shkruaj këto radhë po afrohet 85-vjetori i lindjes së gjeniut tonë. Pas çerek shekulli që bashkëpunoj me të, kam kuptuar se, nëse mbijetova në këtë biznes të vështirë në një vend si Shqipëria, ishte besimi te letërsia e Kadaresë, një besim i ngjashëm si te Hyjnia, po të perifrazoj një shprehje të tij.

Në shenjë mirënjohjeje ndaj tim vëllai, Feridit, e kam bërë këtë foto. Ishte ai që më njohu me Kadarenë. Ndërsa po më zgjaste librin e parë për botim ("Dialog me Alain Bosquet"), Feridi i tha: shkruaji diçka Bujarit, ndryshe ky takim do t'i duket si ëndërr. Ai mori stilolapsin dhe shkroi autografin e parë dhe të vetëm për mua: "Zotit Bujar Hudhri, duke i uruar suksese në punën e tij fisnike dhe si fillim i bashkëpunimit tonë. Ismail Kadare. 14 nëntor 1995".

Fotografia në të majtë është më e shtrenjta që kam në marrëdhënien me çiftin e shquar Kadare dhe të gjithëve aty dua t'u shpreh mirënjohjen time të thellë. Këtu jemi në një kafe në Ishull Lezhë. Para 15 vjetësh, ndërsa po ktheheshim nga Panairi i Librit në Ulqin. Në mes të zonjës Helena dhe zotit Kadare është mbesa e tyre, Doruntina. Pranë saj, vajza ime Enxhi, tani drejtore e "Onufrit". Djathtas saj, djali im Davidi, që është botuesi i "Minervës". Pranë meje është bashkëshortja ime, Suzana, mbështetja e së cilës për të gjitha ëndrrat e mia ka qenë vendimtare.

KADARE

Dialog me Alda Bardhylin

Kohë për rrëfim

Onufri